

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5405
E martë, 20 shkurt 2018
çmimi 0.40 €

Telegram ngushëllimi Ali Ahmetit për Abdilhaqim Ademin

FAQE 12

Nga Ismet
SYLEJMANI



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE

PSE NUK E PRANOJ DEKORATËN E KËTIJ REGJIMI

Rexhep QOSJA



NJË DEGENIE PAVARËSI E SOVRANITET

Salihe SALIHU -
PhD kandidat



SHBA-JA NUK E PËRKRAH SHKËMBIMIN E TERRITOREVE, KËRKON ZGJIDHJE KREATIVE

F. 2

EKONOMI

SFIDA PËR KOSOVËN MBETEN PAPUNËSIA DHE INVESTIMET E HUAJA

F. 9

RRITEN ÇMIMET E KONSUMIT NË KOSOVË PËR 0.9 PËR QIND

F. 8

KULTURË

NJË SHITORE PËR ADEM DEMAÇIN

F. 15

Lulëzim ETEMAJ



SPORT

GËRBESHI: JEMI NË RRUGËN E DUHUR PËR TITULL

F. 16

KOSOVA SOT GRUMBULLOHET NË POLONI

F. 16



FLET PËR "EPOKËN E RE", AVNI ARIFI ■ FAQE 4-5

Dialogu teknik do të ketë dinamikë dhe qasje të re

- Takimi i radhës i dialogut është caktuar për 26 dhe 27 shkurt

Shefi i delegacionit të Kosovës për dialog teknik, Avni Arifi, ka paralajmëruar se ky proces do të jetë sa më gjithëpërfshirës dhe transparent. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se temat që do të diskutohen në këtë format të dialogut nuk i takojnë vetëm një

koalicioni qeverisës. Arifi ka treguar se sot (martë) me komisionin parlamentar për politikë të jashtme do të diskutojnë për temat e dialogut teknik, ku do të synohet që në secilin hap të këtij procesi të ketë qasje gjithëpërfshirëse. Sipas tij, procesi i dialogut teknik do të ketë një dinamikë të re, me një

qëllim dhe fokus tjetër. Arifi ka mohuar çdo mundësi që në procesin e dialogut për normalizim të marrëdhënieve Kosovë - Serbi të diskutohet për shkëmbin të territoreve. Sipas tij, Kosova me askënd nuk ka as çka të ndaj e as çka të shkëmbejë territor të vet

Haradinaj: Ratifikimi i demarkacionit, gjatë javës



Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka bërë me dije se ratifikimi i demarkacionit të kufirit me Malin e Zi do të kryhet gjatë javës. Në këtë kontekst, ai ka

thënë se zgjidhja e demarkacionit është në proces dhe se nuk do të ketë kthim prapa. "Tash ka rëndësi ta kemi mirëkuptimin e të gjithëve, të Listës Serbe, të

Vetëvendosjes dhe të çdo deputeti në Kuvend, se është një moment për të cilin duhet të jemi të gjithë bashkë", është shprehur Haradinaj ■ FAQE 3



Vetëvendosja kërkon hetim ndërkombëtar për aktivistët e dënuar

RENOVA
Maqedoni
Xhepçisht-Tetovë
Çarëz-Ferizaj
PUTZ
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

SatStyro
Mushnikovë-Prizren-Kosovë
Product of EPS and XPS
Mob.: +377(0) 44 506 815
Tel&Fax: +381(0) 29 246 030
e-mail: sat_styro@yahoo.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302.
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Thaçi kërkon mbështetjen e ShBA-së për demarkacionin, dialogun dhe ushtrinë

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, në takim me senatorin amerikan Ron Johnson ka kërkuar mbështetjen e ShBA-së lidhur me ratifikimin e marrëveshjes për shënimin e vijës kufitare me Malin e Zi, për procesin e normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë si dhe për domosdoshmërinë e transformimit të FSK-së në ushtri të Kosovës

PRISHTINË, 19 SHKURT - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka pritur të hënën në takim senatorin amerikan Ron Johnson, të cilin e ka falënderuar për mesazhet dhe urimet për 10-vjetorin e pavarësisë. "Jemi mirënjohës për mbështetjen e vazhdueshme të ShBA-së, e cila ka qenë përcaktuese për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës. Mesazhet dhe urimet e presidentit Trump janë inkurajuese, për të punuar edhe më shumë", ka deklaruar presidenti Thaçi.

Ai e ka informuar senatorin Johnson për konsensusin e krijuar lidhur me ratifikimin e marrëveshjes për shënimin e vijës kufitare me Malin e Zi, për procesin e normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë si dhe për domosdoshmërinë e transformimit të FSK-së në ushtri të Kosovës.

Presidenti Thaçi ka kërkuar mbështetjen e ShBA-së për këto tema, në mënyrë që këto procese të kenë sukses. Ndërsa amerikanin Ron Johnson ka ofruar mbështetjen e plotë në të gjitha fushat për Kosovën.

Haradinaj: Përkrahja e ShBA-së, shumë e rëndësishme për Kosovën

Senatorin amerikan Ron Johnson në takim e ka pritur edhe kryeministri i Republikës së Kosovës, Ramush



Haradinaj. Në këtë takim u bisedua për zhvillimet politike aktuale në vend, për mbështetjen e gjithanshme të Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Kosovën në procesin e shtetndërtimit dhe për thellimin e mëtejme të bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve, posaçërisht në fushën e zhvillimit ekonomik dhe të sundimit të ligjit.

Kryeministri Haradinaj falënderoi senatorin Johnson për vizitën në Kosovë, duke theksuar nevojën për mbështetje të mëtejme në të gjitha proceset nëpër të cilat po kalon Kosova. "Përkrahja e ShBA-së është shumë e rëndësishme për ne. Kosova

dhe populli i saj do të jenë përherë falënderues për ndihmën që ShBA-ja dhe populli amerikan kanë dhënë në të gjitha periudhat", tha kryeministri Haradinaj.

Kryeministri Haradinaj tha se procesi i dialogut me Serbinë duhet të afatizohet në kohë dhe të përmbyllet me njohje reciproke. Sipas një komunikate, duke uruar Qeverinë dhe popullin e Kosovës për krenmtimin e dhjetëvjetorit të pavarësisë, senatori amerikan Ron Johnson tha se ShBA-ja do të vazhdojë të jetë mbështetëse e fuqishme në zhvillimin ekonomik, demokratik dhe të konsolidimit të shtetndërtimit të Kosovës.

BE-ja komenton fjalën e kryeministrit Rama në Kosovë

BRUKSEL, 19 SHKURT - "Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, me rastin e 10-vjetorit të pavarësisë së Kosovës, sugjeroi që Kosova dhe Shqipëria të kenë një president të përbashkët. Kjo tingëllon si një projekt i Shqipërisë së madhe. Ka ndonjë koment komisioni për mundësinë e ndryshimit të kufijve në Ballkan?"

Kjo ishte pyetja e gazetarëve në daljen e radhës para medieve të zëdhënësës për Politikën e Jashtme dhe Sigurinë në Bashkimin Evropian, Catherine Ray. "Deklarata që mund të interpretohen si ndërhyrje politike në vendet fqinje nuk ndihmojnë në ndërtimin e marrëdhënieve të mira mes fqinjëve. Bashkimi Evropian pret



që në të gjithë rajonin të vijojë ndërtimi i marrëdhënieve konstruktive dhe bashkëpunuese mes vendeve, si dhe të intensifikohet puna me programet përkatëse të reformave, për të avancuar më tej në rrugën e integritimit evropian", tha zëdhënësja.

Catherine Ray ritheksoi qëndrimin e Brukselit sa i takon së ardhmes së Ballkanit Perëndimor. "BE-ja ka mbështetur vazhdimisht pajtimin dhe bashkëpunimin rajonal në Ballkanin Perëndimor. Këshilli Evropian ka theksuar mbështetjen pa ekuivokë për perspektivën e qartë evropiane të Ballkanit Perëndimor, ndaj ne do të vijojmë të punojmë me këto vende", tha Ray.

LAJME SHKURT

Meta i kërkon qeverisë emrat e negociatorëve për paktin detar

TIRANË, 19 SHKURT - Presidenti i Republikës, Ilir Meta, nuk do t'i japë plotfuqishmërinë Ministrisë së Jashtme për të negociuar një marrëveshje të re me Greqinë, nëse nuk korrigjohen disa nga problematikat e konstatuara në shkresën që një javë më parë iu drejtua kreut të shtetit. Presidenti Meta, pasi u konsultua me të gjithë ish-presidentet e shtetit shqiptar si Berisha, Mejdani, Moisiu, Topi dhe Nishani, si dhe me kryetaren e komisionit të politikës së jashtme Mimi Kodheli dhe zëvendëskryetarin Tritan Shehu, me sa duket ka vendosur t'ia kthejë kërkesën Ministrisë së Jashtme për plotësime.

Ilir Meta i është drejtuar me një shkresë ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ditmir Bushatit, për t'i shprehur gjithë problematikat e konstatuara në kërkesën e bërë një javë më parë për dhënien e plotfuqishmërisë, mësohet nga burime pranë presidencës, por edhe nga vetë Ministria e Jashtme e cila ka kontaktuar me stafin e presidentit.

Në këtë shkresë kreu i shtetit do t'i kërkojë ministrit Bushati t'i saktësojë emrat e negociatorëve që do të negociojnë për marrëveshjen e re me Greqinë, pasi presidenti i Republikës nuk mund të firmosë një shkresë dhe emrat të plotësohen nga Qeveria.

Bushati: Në prill presim nisjen e bisedimeve për anëtarësim në BE

TIRANË, 19 SHKURT - Shqipëria pret që në muajin prill Komisioni Evropian ta rekomandojë fillimin e bisedimeve për anëtarësim në Bashkimin Evropian, bazuar edhe në rekomandimin e vitit 2016. Duke folur në konferencën përmbyllëse të Akademisë së Integritimit Evropian, Bushati tha se viti 2018 është një dritare e artë për vendimmarrje.

Bushati ripërsëriti pritshmërinë që Qeveria shqiptare ka për hapjen brenda këtij viti të negociatave të Shqipërisë me BE-në.

Në këtë proces, tha ai, Qeveria e ka të domosdoshme të ndërtojë kanale të qarta komunikimi dhe konsultimi me aktorë të shoqërisë civile. "Strategjia e zgjerimit është një hap pozitiv edhe sa i përket vlerësimit të gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor në mënyrë individuale. Besojmë se në prill Komisioni Evropian do ta rekomandojë fillimin e bisedimeve për anëtarësim të Shqipërisë, bazuar edhe në rekomandimin e 2016-s", u shpreh ministri i Jashtëm. Për kryediplomatën shqiptar "nuk ka vend për vetëkënaqësi". "Procesi i fillimit për anëtarësim për në BE do të jetë një proces edhe më imponues, edhe më kërkuar dhe natyrisht se e konsiderojmë 2018-n si një dritare të artë për një vendimmarrjen për fillimin e bisedimeve për anëtarësim. Qeveria e ka të domosdoshme, sidomos në procesin e anëtarësimit të BE-së për të ndërtuar kanale të qarta komunikimi dhe konsultimi me aktorë të shoqërisë civile. Nuk është se do të negociojmë diçka me BE-në, thjesht do të duhet të negociojmë afatet brenda të cilave marrim përsipër për të zbatuar të drejta dhe detyrime të caktuara", tha Bushati.



Haradinaj: Ratifikimi i demarkacionit, gjatë javës



Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka bërë me dije se ratifikimi i demarkacionit të kufirit me Malin e Zi do të kryhet gjatë javës. Në këtë kontekst, ai ka thënë se zgjidhja e demarkacionit është në proces dhe se nuk do të ketë kthim prapa. "Tash ka rëndësi ta kemi mirëkuptimin e të gjithëve, Listës Serbe, Vetëvendosjes dhe të çdo deputeti në Kuvend, se është një moment për të cilin duhet të jemi të gjithë bashkë", është shprehur Haradinaj

**EPOKA
ERE**

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 19 SHKURT - Ndonëse seanca e jashtëzakonshme për ratifikimin e demarkacionit është paraparë të mbahet sot (e martë), një gjë e tillë nuk do të ndodhë. Shtyrja e seancës për një kohë të pacaktuar është bërë në mungesë të votave të mjaftueshme për ratifikimin e marrëveshjes së demarkacionit të kufirit në mes të Kosovës dhe Malit të Zi. Por, kryeministri i vendit, Ramush Haradinaj, ka thënë se demarkacioni është temë që ka pritur me vjet dhe dëshiron konsultë me të gjitha grupet parlamentare dhe me të gjithë deputetët, në mënyrë që të ketë një seancë të përgatitur mirë. Ai ka thënë se tani ka një ndryshim në gjendjen faktike dhe, sipas Haradinajt, marrëveshja në mes të presidentëve parasheh opsionin e rishikimit dhe të korrektimit të gjendjes në drejtim të Çakorrit dhe Kullës. "Thirrja e seancës për të dielën ishte nga vullneti i madh dhe i mirë pas arritjes së marrëveshjes, por tema

e demarkacionit është temë që ka pritur me vjet dhe për të duhet konsultë me të gjitha grupet parlamentare, me të gjithë deputetët, në mënyrë që të kemi një seancë të përgatitur mirë. Ka një ndryshim në gjendjen faktike. Ka një marrëveshje mes presidentëve, e cila flet për opsionin e rishikimit dhe të korrektimit të gjendjes në drejtim të Çakorrit dhe Kullës. Me gjithë dyshimet, marrëveshja është një materie mes dy presidentëve të vendit. Unë vet si kryeministër kam punuar gjithë kohës për këtë marrëveshje, në substancën e saj dhe i falënderoj të gjithë që kanë qenë të angazhuar. Kjo marrëveshje dhe Ligji për ratifikimin që do t'i kalojnë Kuvendit. Duhet të jetë një dokument dhe duhet të votohen së bashku. Ne do t'i ndjekim të gjitha procedurat dhe përgatitjet për këtë", ka deklaruar Haradinaj. Pavarësisht prej shtyrjes së seancës, kryeministri Haradinaj ka paralajmëruar se zgjidhja e demarkacionit është në proces dhe se nuk do të ketë kthim prapa. Madje, sipas tij, votimi i demarka-

cionit në Kuvend mund të kryhet brenda javës. Haradinaj u ka bërë thirrje të gjitha grupeve parlamentare dhe secilit deputet të Kuvendit të Kosovës që në këtë moment të rëndësishëm të jenë të bashkuar. Në këtë drejtim kryeministri Haradinaj ka kërkuar mirëkuptimin e Listës Serbe dhe të Lëvizjes Vetëvendosjes. "Kemi humbur gati tri vjet për këtë dhe ndoshta na shkon edhe një javë, por duhet të jemi të përgatitur dhe të kemi kujdes në përgatitjen e seancës. Por, kthim prapa nuk ka. Jemi në proces të zgjidhjes së çështjes së demarkacionit. Historia do ta tregojë që nga e gjithë kjo ne kemi fituar të drejtën territoriale të vendit dhe lirinë e lëvizjes dhe e kemi nxjerrë Kosovën nga një pozicion shumë i rëndë. Këtë nuk kishim arritur ta bëjmë të vetëm, pa mirëkuptimin e shumë të tjerëve. Tash ka rëndësi ta kemi mirëkuptimin e të gjithëve, Listës Serbe, Vetëvendosjes dhe të çdo deputeti në Kuvend, se është një moment që duhet të jemi të gjithë bashkë", është shprehur Haradinaj.

Krasniqi: Qëndrimi i Haradinajt për demarkacionin mund ta kthejë këtë proces në pikën zero

Por analisti i çështjeve politike, Milazim Krasniqi, ka thënë se qëndrimi i kryeministrit Ramush Haradinaj për demarkacionin, pas miratimit të deklaratës së dy presidentëve, mund ta kthejë këtë proces në pikën zero. Sipas tij, deklarata e presidentëve Thaçi - Vujanović të përfshihet si pjesë e Ligjit për demarkacionin e të miratohet në Kuvend, mund të jetë e papranueshme për deputetët e LDK-së. Krasniqi ka vlerësuar se bllokimi i ri do të prodhonte zhgënjim shtesë tek qytetarët e Kosovës si dhe do t'i shtonte dyshimet e faktorëve ndërkombëtarë për seriozitetin, madje edhe për aftësinë vendimmarrëse të drejtuesve të institucioneve tona. "Qëndrimi i kryeministrit Haradinaj, që deklarata e presidentëve Thaçi - Vujanović të përfshihet si pjesë e Ligjit për demarkacionin e të

miratohet në Kuvend, ka rrezik ta kthejë çështjen sërish në pikën zero. Çka nëse deputetët e LDK-së nuk e pranojnë këtë propozim, duke dashur ta ruajnë të pacenuar idenë se marrëveshja ka qenë në rregull? Bllokimi i ri do të prodhonte zhgënjim shtesë ndër qytetarët e Kosovës, të cilët me durim pothuajse të pakuptueshëm kanë pritur epilogun e bllokimit të deritashëm. Pra, ka rrezik që pakënaqësia e akumuluar të mos mund të mbahet më tutje, pasi mesazhi nga drejtuesit shtetërorë këto ditë ka qenë se kjo punë tashmë llogaritet e përfunduar. Nga ana tjetër, një bllokim i ri i demarkacionit gjithsesi do t'i shtonte dyshimet e faktorëve ndërkombëtarë për seriozitetin, madje edhe për aftësinë vendimmarrëse të drejtuesve të institucioneve tona", ka shkruar Krasniqi në llogarinë e vet në "Facebook".

Flet për "Epokën e re", Avni Arifi

Dialogu teknik do të ketë

- Takimi i radhës i dialogut është caktuar për 26 dhe 27 shkurt

Shefi i delegacionit të Kosovës për dialog teknik, Avni Arifi, ka paralajmëruar se ky proces do të jetë sa më gjithëpërfshirës dhe transparent. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se temat që do të diskutohen në këtë format të dialogut nuk i takojnë vetëm një koalicioni qeverisës. Arifi ka treguar se sot (martë) me komisionin parlamentar për politikë të jashtme do të diskutojnë për temat e dialogut teknik, ku do të synohet që në secilin hap të këtij procesi të ketë qasje gjithëpërfshirëse. Sipas tij, procesi i dialogut teknik do të ketë një dinamikë të re, me një qëllim dhe fokus tjetër. Arifi ka mohuar çdo mundësi që në procesin e dialogut për normalizim të marrëdhënieve Kosovë - Serbi të diskutohet për shkëmbin të territoreve. Sipas tij, Kosova me askënd nuk ka as çka të ndaj e as çka të shkëmbejë territor të vet

EPOKA E RE**Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 19 SHKURT - Shefi i delegacionit të Kosovës për dialog teknik, Avni Arifi, ka bërë me dije se ky proces në mes të Kosovës dhe Serbisë do të ketë një dinamikë dhe qasje të re. Ai ka deklaruar se do të synohet që dialogu teknik në Bruksel në mes të Kosovës dhe Serbisë të jetë sa më gjithëpërfshirës dhe transparent. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Arifi ka thënë se tema të cilat do të diskutohen në këtë proces nuk janë vetëm të një koalicioni qeverisës. "Gjithsesi se do të ketë një

dinamikë të re, por qëllimi dhe fokusi do të jetë tjetër. Pra, do të fokusohemi për implementimin e marrëveshjeve ekzistuese. Ne të martën do të diskutojmë edhe me komisionin parlamentar për politikë të jashtme dhe synojmë që në secilin hap të veprimeve tona të kemi qasje gjithëpërfshirëse. Tema për të cilën po flasim nuk është vetëm temë e një koalicioni qeverisës të një mandati, andaj do të përpiqemi të jemi sa më gjithëpërfshirës dhe sa më transparent", ka thënë Arifi.

Ai ka treguar se takimi i radhës për dialog teknik është caktuar për datën 26 dhe 27 shkurt.



Karemi: Transformimi i FSK-së të bëhet në koordinim me ShBA-në



PRISHTINË, 19 SHKURT - Asistenti i sekretarit të Mbrojtjes së Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA), Robert S. Karemi, është takuar me ministrin e Forcës së Sigurisë Kosovës (FSK), Rrustem Berisha dhe komandantin e kësaj force, gjenerallejtënant Rahman Rama, me të cilët ka diskutuar rreth transformimit të FSK-së në Forcë të Armatosura të Kosovës. Zyrtari i lartë amerikan ka vlerësuar se procesi i transformimit të FSK-së duhet të jetë kushtetues dhe me hapa të koordinuar me ShBA-në dhe partnerët e tjerë strategjikë. Ai ka folur edhe për interesimin e madh që ShBA-ja po ua kushton zhvillimeve në fushën e sigurisë në Ballkan dhe më gjerë. Me këtë rast, Karemi ka vlerësuar lart përkushtimin që

procesin e transformimit të FSK-së të jetë transparent dhe mbi baza kushtetuese dhe me hapa të koordinuar me ShBA-në dhe partnerët e tjerë strategjikë. Ndërkaq ministri i FSK-së, Rrustem Berisha, ka falënderuar ShBA-në për ndihmën e gjithanshme për FSK-në. Ai e ka siguruar mysafirin se transformimi i FSK-së do të bëhet përmes ndryshimeve kushtetuese dhe në koordinim me partnerët strategjikë, proces i cili do të jetë shumë transparent. Ndërsa komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rahman Rama, ka deklaruar se FSK-ja është forcë profesionale, me koncept perëndimor dhe e mbështetur në koncepte dhe doktrinën amerikane.

dinamikë dhe qasje të re



Arifi ka deklaruar se në këtë takim dhe në takimet e radhës do të insistohet për zbatimin e marrëveshjeve të arritura në këtë proces.

"Mosimplementimi i marrëveshjeve apo zvarritja e tyre nga të dyja palët nuk i shërben as qëllimit të dialogut e as ndërtimit të mirëbesimit të ndërsjellë. Do të implementojmë të gjitha obligimet që kemi marrë, njëkohësisht do të insistojmë që obligimet e marra nga pala tjetër të implementohen në tërësi", është shprehur ai.

Shefi i stafit të kabinetit të kryeministrit ka mohuar çdo mundësi që në procesin e dialogut për normalizim të marrëdhënieve Kosovë - Serbi të diskutohet për shkëmbin të territoreve. "Asnjë mekanizëm në Kosovë, shtetëror apo partiak, nuk e përkrah idenë e ndarjes. Qeveria e Kosovës çdo herë ka qenë shumë e qartë në këtë dhe është e pakuptueshme pse përsëritet një pyetje e tillë. Kosova me askënd nuk ka as çka të ndaj e as çka të shkëmbejë territor të vet. Idetë për destabilizim permanent të rajonit kanë ekzistuar edhe më parë por, fatmirësisht, ide të tilla nuk janë përfillur", është shprehur Arifi.

"Epoka e re": Z. Arifi, jeni emëruar përfaqësues i Qeverisë në dialogun për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Çfarë veprimesh keni ndërmarrë prej se jeni emëruar në këtë post?

Arifi: Që nga emërimi im, bashkë me kolegë të tjerë kemi filluar të analizojmë çdo gjë që

ka ndodhur në procesin e deritanishëm, njëkohësisht t'i shikojmë mundësitë që këtij procesi t'ia japim drejtimin që është në funksionin të realizimit të qëllimeve të shtetit të Kosovës. Ky proces ka arritur në fazën që domosdoshmërisht kërkon një epilog. Po synojmë që ky epilog të nënkuptojë implementimin e marrëveshjeve ekzistuese dhe përgatitjen për fazën tjetër, atë të marrëveshjes përfundimtare. Ne jemi shumë të interesuar ta arrijmë normalizim të raporteve me Serbinë dhe ky normalizim qubet njohje reciproke si dy shtete të pavarura dhe sovraane.

"Epoka e re": Kur pritet të rifillojë dialogu me Serbinë, meqenëse takimi i parë u anulua për shkak të ngjarjeve që tashmë dihen?

Arifi: Takimi i radhës është caktuar për datën 26 dhe 27 shkurt. Kosova do të marrë pjesë në këtë proces. Pra, e kemi konfirmuar praninë tonë.

"Epoka e re": Çfarë do të ndryshoni në këtë proces? Do të ketë ky proces një dinamikë të re?

Arifi: Gjithsesi se do të ketë një dinamikë të re, por qëllimi dhe fokusi do të jetë tjetër. Pra, do të fokusohemi në implementimin e marrëveshjeve ekzistuese. Të martën do të diskutojmë edhe më komisionin parlamentar për politikë të jashtme dhe synojmë që në secilin hap të veprimeve tona të kemi qasje gjithëpërfshirëse. Tema për të

cilën po flasim nuk është vetëm temë e një koalicioni qeverisës të një mandati, andaj do të përiqemi të jemi sa më gjithëpërfshirës dhe sa më transparentë.

"Epoka e re": Një numër i caktuar i marrëveshjeve të arritura në këtë proces nuk janë zbatuar. Si duhet të veprojnë Kosova që këto marrëveshje të zbatohen?

Arifi: Do të insistoj të implementohen. Mosimplementimi i marrëveshjeve apo zvarritja e tyre nga të dyja palët nuk i shërben as qëllimit të dialogut e as ndërtimit të mirëbesimit të ndërsjellë. Do t'i implementojmë të gjitha obligimet që na kemi marrë, njëkohësisht do të insistojmë që obligimet e marra nga pala tjetër të implementohen në tërësi.

"Epoka e re": Serbia sërish ka nxitur idenë e ndarjes së territorit të Kosovës, duke pretenduar se kjo mund të bëhet objekt negociatash midis dy shteteve. Cila është përgjigja e Qeverisë së Kosovës në këtë rast?

Arifi: Asnjë mekanizëm në Kosovë, shtetëror apo partiak, nuk e përkrah idenë e ndarjes. Qeveria e Kosovës çdoherë ka qenë shumë e qartë në këtë dhe është e pakuptueshme pse përsëritet një pyetje e tillë. Kosova me askënd nuk ka as çka të ndaj e as çka të shkëmbejë territor të vet. Idetë për destabilizim permanent të rajonit kanë ekzistuar edhe më parë por, fatmirësisht, ide të tilla nuk janë përfillur.

Klinaku: Deklarata e Ramës për president të përbashkët forcon sovranitetin e Kosovës



PRISHTINË, 19 SHKURT - Sekretari i Lëvizjes për Bashkim (LB), Avni Klinaku, ka thënë se nuk ka asgjë të keqe lidhur me deklaratën e kryeministrit të Shqipërisë, Edi Rama, që Kosova dhe Shqipëria ta kenë një president të përbashkët. "Ne nga Lëvizja për Bashkim e kemi mirëpritur një deklaratë të tillë, edhe pse mendoj se kjo gjë duhet bërë me kujdes dhe një përputhje me rrethanat. Asgjë të keqe nuk do të kishte që të kemi një treg të përbashkët dhe të shkojmë drejt integriteteve", ka thënë Klinaku në "Info Magazine" të "Klan Kosovës". Sipas tij, një deklaratë e tillë e Ramës vetëm e forcon sovranitetin e Kosovës. "Do t'i kisha propozuar që edhe rezidencën ta bëjë në Prizren dhe ta bëjmë presidentin e përbashkët", ka thënë Klinaku.

Një decenie pavarësi e sovranitet



Salihe SALIHU -
PhD kandidat

Kosova pas çlirimit nga okupimi serb në vitin 1999 nuk arriti që menjëherë prej atij momenti ta gëzojë pavarësinë dhe ta shtrijë sovranitetin. Normat e fabrikuara ndërkombëtare e ndaluan ecurinë e Kosovës për procesin më dinamik drejt pavarësisë dhe sovranitetit. Ky lloj prolongimi ishte arsyetuar me aspiratën e ndërkombëtarëve që të arrihet paqja para pavarësisë dhe sovranitetit. Me këtë rezonim të faktorit ndërkombëtar u pajtua edhe faktori i brendshëm dhe veçori konform marrëveshjes me ndërkombëtarët, që të kontribuojë për ruajtjen e paqes dhe stabilitetit. Por, pavarësia dhe sovraniteti ishin elementë kyç që Kosova të bëjë një shtet karshi shteteve të tjera të botës. Prandaj, angazhimet e panumërta të aktorëve politikë për ta kurorëzuar e finalizuar statusin e Kosovës u zhvillua me negociata të ndërlikuara gjatë periudhës prej pasluftes e deri te Dita e Pavarësisë së Kosovës me 17 shkurt 2008.

Pavarësia e legjitimuar

17 shkurti 2008 ishte data për të cilën ishin sakrifikuar shumë breza dhe tani sakrificat e tyre u hynjësua në Pavarësi. Me shikim drejtuar në këtë manifestim hynjorë lirshëm mund të konstatohet se kjo ishte Dita më madhështore që po e festonin shqiptarët që prej 1912-s. Gjaku i heronjve, dëshmorëve e martirëve ishte në gurë themelin e Momentumit të ri. Pavarësia e Kosovës u bë një faktum, një realitet i ri duke e shpallur Republikën e Kosovës si shtet të pavarur e sovran. Pavarësinë e Republikës së Kosovës e mbështeten shtetet më të fuqishme Perëndimore duke e njohur si shtet të pavarur dhe sovran. Me këto njohje Republika e Kosovës fitoj legjitimitetin ndërkombëtar.

Republika e Kosovës si shteti i ri mori përsipër që me një qeverisje të butë por të drejt ta fuqizon performancën e vet shtetërore si brenda vendit edhe jashtë saj. Në raportin e brendshëm qeverisja vendore bëri hapa zhvillimor që të përmirëson jetën e qytetarëve të vet. Mirëpo ndryshim dhe përmirësim nuk arrihen me minutazhat e orëve apo ditëve por kërkohet kohë që të formohet dhe zhvillohet së pari mentaliteti i të bërit shtet, që në radhë të parë të mendohet që shteti të ruhet e të mbrohet. Ky zhvillim i mendësisë është primarë për

qëndrueshmërinë e një shteti të pavarur e sovran. Kur në mendjen e secilit ngulitet se pa një shtet të fuqishëm nuk mund të mbrohet as familja e shoqëria por as prona shoqërore e private atëherë mund të themi se duam shtetin. Kur shteti është me prioritet numër një në mendësinë e çdo qytetari atëherë s'ka forcë që mund ta mposhte ekzistencën e tij. Pas këtij formimi në kokën e secilit mund të mendojmë për zhvillimin e mëtutjeshëm të shtetit. Vetëkuptohet se zhvillimi shoqëror kalon nëpër procese dhe se çdo proces ka ecurit e veta dhe duhet të merret parasysh që procesi zhvillimor përbëhet nga nuancat specifike.

Në vëzhgim të këtyre nuancave në shtetin tonë mund të themi se hapat zhvillimor janë të matshëm por jo të kënaqshëm apo të përmbushur. Zhvillimi ekonomik nuk është i nivelit të dëshirueshëm apo që mund të mburremi se i plotësoj aspiratat as të qeveritarëve por as të popullit. Ngacjet e pakontrolluara shkaktojnë një lloj dëshpërimi por faktbardhësisht nuk shkaktojnë ndonjë kolaps në zhvillimin shoqëror të vendit. Kjo gjendje duhet që sa ma parë të përmirësohet. Fatmirësisht orvatjet për të hap perspektivën ekonomike me ritëm më të theksuar po vazhdojnë ndonëse këto premtime të udhëheqësve janë ende në formë deklarative megjithëkëtë kjo çështje mbetet në fazën e pritshmërive.

Sovraniteti

Në raportin ndërkombëtar Republika e Kosovës ka një progres të kapshëm përmes anëtarësimit në disa instanca ndërkombëtare dhe vazhdon me përgatitë terrenin për aplikime të reja për t'u anëtarësuar në më shumë instanca tjera ndërkombëtare.

Por në këtë vit jubilar, 10-vjetori i pavarësisë dhe vit i Skënderbeut, duhet të jetë vit i Kosovës evropiane. Kosova duhet të rrisë aktivitetin e saj për integrim në Unionin Evropian. Gjithë liderët shqiptarë të përpiqen që në koordinim me njëri tjetrin të prezantojnë platformën politike në raport me ndërkombëtarët për vitin 2018 - të shpallin vitin 2018 si vit jubilar për anëtarësim si simbolik e 100-vjetorin të përfundimit të Luftës së Parë Botërore dhe të bëhet trysni për të mundësuar shansin për pakon e anëtarësimit të Ballkanit Perëndimor.

Me një angazhim të gjithanshëm të gjitha përfaqësitë e Kosovës të agjitojnë në vende ku ata përfaqësojnë Kosovën që ky rast të mos humbet sikurse që u humb rasti i propozuar në Samitin e Selanikut që parashikonte që viti 2014 të ishte vit i anëtarësimit të Ballkanit Perëndimor. Ky argument para ndërkombëtarëve do lëvizë gurët për të mundësuar rrjed-

hën e procesit.

Përkundër turbulencave të herëpashershme, Republika e Kosovës përballoi çdo stuhi. Në shënimin e një decenie pavarësi dhe sovranitet, Republika e Kosovës, duke qeverisur me parimin e organizimit të lirisë dhe vetëpërmbytjes, ka arritur të gjenerojë një bashkëjetesë të sigurt për të gjithë qytetarët e saj. Gjithashtu, ka përmirësuar bashkërendimin për një qeverisje të përbashkët që si moto ka për të mirën e përbashkët për të gjithë qytetarët.

Republika e Kosovës sovranë është dëshmuar se ka kapacitete ta mbrojë territorin e saj nga çdo lloj tendencë shkatërrimtare qoftë nga aktorë të brendshme apo të jashtëm. Gjatë një decenie pavarësi Republika e Kosovës sovranë sfidoi planifikimin e aktit terrorist në Prishtinë si dhe parandaloi sulmin pompoz përmes vijës hekurudhore.

Sovraniteti i Republikës së Kosovës ka nevojë për secilin qytetar sepse secili nga ne është sovran dhe me bashkimin e sovranitetit individual kemi unifikuar sovranitetin shtetëror. Me këtë formulë Republika e Kosovës ka rritur fuqinë e shtetit dhe ka kontinuitet për progres për të ardhmen. Në gjithë botën Republika e Kosovës, me arritjet e veta gjatë një decenie pavarësi e sovranitet, është një dëshmi e një storie të suksesit të shtetit më të ri në Evropë.

Sot mbahet greva dyorëshe në të gjitha institucionet arsimore

PRISHTINË, 19 SHKURT - Sindikata e Bashkuar e Arsimit, e Shkencës dhe e Kulturës (SBASHK) nëpërmjet një komunikate për medie ka bërë me dije se sot (e martë) do të ketë grevë dyorëshe në të gjitha institucionet arsimore "Greva do të mbahet në dy orët e para të mësimi të paradites dhe në dy orët e para të mësimi të pasdites në të gjitha shkollat e Kosovës, kurse universitetet do të jenë në grevë nga ora 10:00 deri në orën 12:00", është thënë në komunikatën e SBASHK-ut. Ky vendim, sipas SBASHK-ut, ka ardhur duke pasur parasysh se pas grevës njëorëshe në tërë sistemin arsimor, kishte reflektim të pamjaftueshëm të

Qeverisë së Kosovës ndaj kërkesave të punësuarve në arsimin e Kosovës.

SBASHK-u ka bërë me dije se do t'i vazhdojë veprimet sindikale, ashtu si është vendosur në mbledhjen e jashtëzakonshme të Këshillit Drejtues. "Këshillat greviste, që janë formuar me kohë, në shkollat e njësi akademike, do të kujdesen për mirëvajtjen e grevës dyorëshe dhe do t'i mbajnë të informuar këshillat greviste komunale, gjegjësisht këshillin grevist të universiteteve, kurse këta këshilla do të jenë në komunikim me këshillin qendror grevist që është në selinë e SBASHK-ut", është theksuar më tutje në këtë komunikatë.



ShBA-ja nuk e përkrah shkëmbimin e territoreve, kërkon zgjidhje kreative

Ambasada Amerikane në Prishtinë ka bërë me dije se Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) nuk e përkrahin idenë për shkëmbim të territoreve në mes të Kosovës dhe Serbisë

PRISHTINË, 19 SHKURT - "Ne nuk e mbështesim shkëmbimin e territorit apo vendosjen e precedentëve që do të shkaktonin më shumë probleme sesa zgjidhje, por të gjitha palët duhet të jenë kreative për gjetjen e një zgjidhjeje", është thënë në përgjigjen e Ambasadës Amerikane në Prishtinë dhënë "Radios Evropa e Lirë".

Në këtë përgjigje është bërë e qartë se Shtetet e Bashkuara vazhdojnë ta mbështesin fuqishëm dialogun e ndërmjetësuar nga BE-ja ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Ambasada Amerikane në Prishtinë i ka inkurajuar të dyja palët t'i përshpejtojnë përpjekjet e tyre për normalizimin e marrëdhënieve".

ShBA-ja u bënë thirrje të dyja palëve t'i shfrytëzojnë mundësitë për të bërë përparim në këtë çështje. Po ashtu, thuhet se ShBA-ja do t'i mbështesë të dyja palët për të arritur një marrëveshje gjithëpërfshirëse, e cila është e vetmja mënyrë për ta zhbllokuar të ardhmen e Kosovës dhe të Serbisë drejt Perëndimit.

Një shkëmbim i tillë territorësh mes dy vendeve, sipas Petrit Zogaj nga Lëvizja Fol, do të shkaktonte efekte tek shtetet e tjera të rajonit. Zogaj ka thënë për "Radios Evropa e Lirë" se kjo do të mund të nxiste edhe dhunë.

"Nuk shoh formulë të thjeshtëzuar se si do të mund të shkëmbehen territoret mes Kosovës dhe Serbisë, pa pasur efekte rajonale. Këto efekte rajonale sigurisht që mund të jenë të dhunshme. Mund të jenë me gjakderdhje dhe janë shumë të paparashikueshme si procese se sa që kishte me qenë një marrëveshje pajtuese mes Serbisë dhe Kosovës", ka thënë Zogaj.

Debatet për shkëmbim territorësh në mes të Kosovës dhe Serbisë janë përmendur nga shumë media në Kosovë dhe Serbi si zgjidhje e mundshme në mes të Kosovës dhe Serbisë. Presidenti serb Aleksandër Vuçiq u ka bërë thirrje Shteteve të Bashkuara të ndihmojnë t'i bindin shqiptarët e Kosovës që të jenë gati për zgjidhje fleksibile që do të mundësojnë një kompromis.



Vetëvendosja kërkon hetim ndërkombëtar për aktivistët e dënuar

Prishtinë, 19 shkurt - Deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje, Arbërie Nagavci dhe Liburn Aliu, kanë kërkuar zbatimin e kërkesave të miratuara nga Kuvendi lidhur me rastin, që ata e quajnë të montuar, të katër aktivistëve të dënuar të kësaj lëvizjeje.

Në një konferencë për media, Nagavci e Aliu kanë thënë se duhet të zbatohen nga Qeveria pikat të cilat janë votuar në Kuvendin e Kosovës. Ata kanë thënë se duan hetim për të gjithë hierarkinë e zyrtarëve në këtë

rast. "Nuk mund të ketë hetim të rregullt nëse, ta zëmë, ish-ministria e Drejtësisë, Dhurata Hoxha, të vazhdojë të jetë ministre. Pra, duhet të ndodhin paraprakisht shkarkimet e më pas hetimi", ka thënë Aliu, duke shtuar se personat që janë pjesë e hetimit nuk mund të jenë edhe pjesë e Qeverisë.

Nagavci e Aliu e kanë përsëritur se vendimi për t'i dënuar me burgim aktivistët e tyre është komplet arbitrar dhe i pabazuar në kurrfarë fakti.

Gjykata Themelore në Prishtinë i pati shpallur fajtorë deputetin e Vetëvendosjes, Frashër Krasniqi, si dhe tre aktivistët e tjerë të kësaj partie, Atdhe Arifi, Adea Batusha dhe Egzon Haliti, të cilët akuzoheshin për sulm ndaj Kuvendit të Kosovës.

Gjykata vendoi që Krasniqi të dënohet me tetë vjet burgim, Atdhe Arifi me gjashtë vjet, Egzon Haliti me pesë vjet e gjashtë muaj, ndërsa Adea Batusha është dënuar me dy vjet burgim me kusht.

Guinea-Bissau rikonfirmoi njohjen për Kosovën

PRISHTINË, 19 SHKURT - Zyra e Presidentit të Kosovës përmes një komunikate për medie ka njoftuar se presidenti Hashim Thaçi ka pritur të hënën në takim ministrin e Shtetit dhe shefin e Shtatmadhorisë së presidentit të Guinea-Bissau, Fabien Sagna dhe këshilltarin e presidentit, Paulino Cabral. "Në këtë takim ministri i shtetit të Guinea-Bissau, Fabien Sagna,

ia dorëzoi presidentit Thaçi letrën e presidentit të Guinea-Bissau, Jose Mario Vaz, me të cilën rikonfirmohet njohja e Kosovës nga ky shtet", është thënë në komunikatën e zyrës së presidentit të Kosovës. Gjithashtu, në komunikatë thuhet se Sagna, në emër të presidentit Vaz, ka urrear presidentin dhe popullin e Kosovës për 10-vjetorin e pavarësisë.



Rriten çmimet e konsumit në Kosovë për 0.9 për qind

Çmimet e konsumit në muajin janar të këtij viti kanë shënuar rritje për 0.9 për qind krahasuar me vitin paraprak. Kështu është bërë me dije nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)

EPOKA E RE**A. MAVRAJ**

PRISHTINË, 19 SHKURT - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar "Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit" (IHÇK) për muajin janar të vitit 2018. Indeksi i tërësishtëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit në vend është më i lartë për 0.2 % në muajin janar 2018, krahasuar me muajin dhjetor 2017. Kjo kryesisht është shpjeguar me ngritjen e çmimeve të konsumit të nëngrupet e COICOP-it: pemë (1.5 %), perime (10.2 %), furnizim me ujë dhe shërbime të ndryshme, që kanë të bëjnë me vendbanimin (2.5 %), përdorim i pajisjeve për transportin personal (0.6 %), me një ndikim të përbashkët të katër nëngrupeve prej 0.5 përqindësh në IHÇK.

Ngritja u neutralizua kryesisht nga rënia e çmimeve të kon-

sumit të nëngrupet: qumësht, djathë dhe vezë (-1.2 %); rrymë, gaz dhe lëndë djegëse të tjera (-1.6 %); shërbime për transport (-3.1 %) - (rënie e çmimit të bileteve me aeroplan) me një ndikim prej (-0.3 %) në IHÇK. Shkalla e inflacionit, e matur në muajin janar 2018, me muajin janar 2017 ishte (-0.2 %). Indeksi i tërësishtëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit ka pësuar rënie në një mesatare prej (-0.2 %) në muajin janar 2018, krahasuar me muajin janar 2017. Kjo kryesisht është shpjeguar me rënien e çmimeve të konsumit në këtë periudhë të nëngrupet: qumësht, djathë dhe vezë (-3.8 %); perime (-5.3 %); sheqer dhe ëmbëlsira (-6.4 %); rrymë, gaz dhe lëndë të tjera djegëse (-8.7 %) - (rënie e çmimit të energjisë elektrike në muajin janar 2018 për (-15.5 %), krahasuar me tarifaf dimërore të muajit janar të vitit 2017); pajisjet shtëpiake (-2.5 %); pajisjet audiovizuale,



fotografike për përpunimin e informatave (-6.8 %) - me një ndikim të përbashkët të katër nëngrupeve prej (-1.1 %) në IHÇK. "Ngritje e çmimeve të

konsumit në këtë periudhë vërehet te nëngrupet: bukë dhe drithëra (3.7 %); mish (0.8 %); pemë (11.7 %); kafe, çaj dhe kakao (5.7 %); duhan (3.7 %);

shërbime hoteliere (1.8 %) - me një ndikim të përbashkët të katër nëngrupeve prej 0.9 % në IHÇK", është thënë në raportin e ASK-së.



Beqaj, pjesë e Forumit Botëror për Investitorët Engjëj

PRISHTINË, 19 SHKURT (ER) - Ministri i Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Besim Beqaj, po merr pjesë në ceremoninë e Forumit Botëror për Investitorët Engjëj. Në këtë forum, Beqaj do të flasë në panelin kryesor të këtij forumi me temën "Financimi i inovacionit përmes ndikimit të investimeve në Evropën Juglindore". "Në cere-

moninë hapëse të këtij forumi të pranishëm ishin shumë personalitete të larta shtetërore dhe përfaqësues të investitorëve engjëj nga rajoni dhe më gjerë", është thënë në njoftimin e Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë. Në këtë forum u diskutuan mundësitë për investime në startupe dhe ndërmarrësi, për rritjen e

potencialit në teknologji dhe forma të reja për bashkim të kapitalit publik dhe atij privat, me fokus për investime në startupe dhe produkte të shërbimeve inovative. Po në këtë forum po diskutohen mundësitë e bashkëpunimit në mes të investitorëve engjëj në mes të shteteve të Evropës juglindore dhe qeverive.

Ministri Reçica udhëton për në Bruksel

PRISHTINË, 19 SHKURT - Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, ka udhëtuar të hënën për në Belgjikë, ku sot (e martë) do të nënshkruhet marrëveshja për Sigurime Sociale në mes të Republikës së Kosovës dhe Mbretërisë së Belgjikës. Ministri Reçica do ta nënshkruajë marrëveshjen me Maggie De

Block, ministre e Punëve Sociale dhe Shëndetit Publik. Qëllimi i marrëveshjes është interesi reciprok i qytetarëve të të dyja shteteve që të mund t'i realizojnë të drejtat nga fusha e sigurimeve sociale, si e drejta në pension kontributpagues, familjar dhe në pension invalidor të punës.



Sfida për Kosovën mbeten papunësia dhe investimet e huaja



Përfaqësuesit e asocioneve të bizneseve në vend, Berat Rukiqi dhe Agim Shahini, edhe përfaqësuesi i Shoqatës së Eksportuesve, Nexhat Hasani, kanë thënë për gazetën "Epoka e re" se gjatë 10 vjetëve të shtetësisë Kosova ka shënuar progres ekonomik. Megjithatë, ata kanë theksuar se ka mundur të bëhet edhe më shumë, sidomos te punësimi, mbështetja e sektorit privat, eksporti, tërheqja e investitorëve të huaj, si dhe te liria e lëvizjes

EPOKA E RE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 19 SHKURT - Kryetari i Aleancës Kosovare të Bizneseve, Agim Shahini, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se pas dhjetë vjetësh shtet është shënuar progres ekonomik sa i përket infrastrukturës dhe integritimit me ndërtimin e autostradave. "Viti 2018 e ka gjetur Kosovën me infrastrukturë tej më të mirë se dhjetë vjet më herët. Investimet në infrastrukturën rrugore nga dikush u kritikuan se kine paratë po shkojnë në asfalt, megjithatë vlerësojmë se infrastruktura rrugore në Kosovë ka pasur nevojë për përmirësim, gjithashtu ka nevojë edhe më tutje", ka thënë Shahini, duke shtuar se sa iu përket çështjeve të tjera integruese, Kosova mbetet mbrapa si vendi më i izoluar në Evropë.

"Asnjë qeveri s'po e merr fajin mbi supet e veta për këtë izolim. Vlerësojmë se të gjitha qeveritë nuk e kanë kryer punën e vet sa i përket integritetit të Kosovës dhe liberalizimit të vizave", ka thënë Shahini.

Ai ka theksuar se në mungesë të strategjisë kombëtare për zhvillim ekonomik, Kosova nuk ka arritur të jetë vend stabil për investitorët e huaj. "Në mungesë të strategjisë kombëtare për zhvillim ekonomik, kemi pasur investime jo të planifikuara. Shpesh kemi pasur investime të dështuara. Ka raste kur kanë ikur investitorët për shkak se nuk ka pasur legjislacion për siguri të investimeve, por për shkak edhe të burokracisë dhe korrupsionit", ka thënë Shahini. Ai ka pohuar se mbetet për të bërë më shumë në aspektin e punësimit.

"Punësimi në Kosovë nuk ka ndodhur si është menduar, kurse në anën tjetër skemat social çdo ditë po rriten. Duhet të ketë një strategji për ta luftuar varfërinë", ka thënë ai. Po ashtu, Shahini ka dhënë edhe vërejtjet që kanë karakterizuar vendin për dhjetë vjet të shtetësisë. "Në aspektin ekonomik kemi konsumin më të madh të importit në Ballkanin Perëndimor, eksportet janë të limituar dhe prodhimitaria vendore është e dobët karshi konkurrencës së jashtme. Nga 1 janari janë ndërmarrë masat fiskale dhe pritet t'i shohim efektet e saj në të ardhmen, por mundësitë e Kosovës për të qenë lidere në Ballkan nuk i kemi shfrytëzuar. Kjo ka ndodhur në sajë të kufizimit të shumë faktorëve të jashtëm dhe të brendshëm. Mirëpo, pas 10 vjetësh Kosova duhet ta marrë veten. Të gjitha burimet që i kemi në Kosovë duhet t'i shfrytëzojmë dhe ta ruajmë kapacitetin human dhe fuqinë punëtore", ka thënë Shahini. Kurse Berat Rukiqi nga Oda Ekonomike e Kosovës (OEK) ka thënë për gazetën "Epoka e re" se sektori privat, cilësia në arsim, lëvizja e lirë dhe imazhi i vendit, mbesin për t'u dëshiruar. Sipas tij, me të arriturat e

deritashme Kosova ka demantuar skeptikët e pavarësisë së saj. "Sektori privat është një ndër faktorët kryesor që Kosova të jetë storie suksesi në shtetndërtim. Kosova ka demantuar skeptikët dhe kundërshtarët e pavarësisë, të cilët argumentonin zëshëm se Kosova s'mund të ketë qëndrueshmëri ekonomike. Një dekadë shkoi e ne ende dominohemi nga produktet e huaja. Andaj, është koha për prodhime vendore dhe eksporte të tyre në tregjet ndërkombëtare", ka thënë Rukiqi.

Ai ka theksuar se Kosova prodhon shumë diploma, kurse ka pak punëtorë të shkathhtë për tregun e punës. "Edhe pas 10 vjetëve shtetësi ende nuk kemi furnizim të rregullt me energji elektrike. Një dekadë po e shënojmë me një kërkesë bazike, të lëvizim të lirë në rajon dhe Evropë", ka deklaruar Rukiqi.

Kurse kryetari i Shoqatës së Eksportuesve të Kosovës, Nexhat Hasani, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se gjatë këtyre dhjetë vjetëve është shënuar progres i theksuar sa i përket eksportit.

Ai ka kujtuar kohën e pasluftës kur eksporti përbënte vetëm 3-5 për qind të totalit. Por, sipas

tij, në këtë aspekt mbetet për t'u dëshiruar. "Mund të themi se kemi zhvillim edhe të ekonomisë, edhe të eksporteve. Ju e dini se menjëherë pas luftës eksportet e kompanive kanë qenë diku 3-5 për qind, tash kemi rreth 15 për qind. Sigurisht se ka pasur progres, pra ekonomia e Kosovës është duke u zhvilluar. Nuk është i kënaqshëm ai progres, mirëpo mendoj se ka hapësirë më tepër për t'u zhvilluar. Kosovën e presin ditë të mira me hyrjen në BE me anë të marrëveshjeve së MSA-së", ka deklaruar Hasani.

Ai ka shtuar se me anëtarësimin në Organizatën Botërore të Tregtisë, Kosova do të krijojë një bazament të shtetndërtimit. "Shoh se në një të ardhme shumë të shpejtë Kosova do të jetë anëtare e Organizatës Botërore për Tregti dhe e ardhmja jonë është kah Bashkimi Evropian dhe shtetet e Bashkuara të Amerikës. Shpresoj se me kërjt këto pengesa që i kemi dhe me punën ose mospunën e njerëzve tanë, ka progres të pakontestueshëm. Ka pasur mundësi të bëhet edhe më shumë. Mendoj se Kosova ka krijuar një bazë të mirë për të rinjtë tanë", ka thënë Hasani.

"MENDIME TË ZGJEDHURA PËR ADEM DEMAÇIN" (8)

ADEM DEMAÇI HYRI NË POLITIKË PËR T'I DHËNË ASAJ E JO PËR TË MARRË NGA AJO



Selatin NOVOSELLA

164. Metush Krasniqi, bashkëveprimtar me Adem Demaçi: Për mua dhe Adem Demaçin synim jetësor ka qenë bashkimi kombëtar Me Adem Demaçi jemi pajtuar se qëllim jetësor i yni ishte çlirimi i Kosovës dhe Viseve tjera shqiptare të pushtuara nga Jugosllavia dhe bashkimi i tyre me Shqipërinë. Ndërsa, sa i përket sistemit komunist në Shqipëri, ishim të bindur se nuk do të duhej të merreshim me të sepse ai, me kohë, do të binte.

165. Mevlde Saraçi, veprimtare e dalluar e çështjes kombëtare: Adem Demaçi, qëndresa shqiptare

Duke qenë edhe vet veprimtare dhe e burgosur politike ndiej dhembje dhe krenari njëkohësisht për të gjithë atdhetarët që pësuan në burgjet jugosllave, si nga pushteti serb si nga bashkëpunëtorët e tyre që gjithmonë i kanë gjetur në mesin tonë, e në veçanti për Heroin e kombit Adem Demaçin, qëndresën shqiptare.

166. Migena Arllati, profesoreshë: Fjalët e Adem Demaçit prisnin më keq se shpata

Në aksiomën "E para ishte fjala!" do të bazohet edhe Adem Demaçi që në rininë e tij të hershme. Që nga fillimi ai e kishte treguar interesimin ndaj vendit dhe kombit me fjalë. Nuk kishte ditë që të mos fliste dhe rebelohej, pasha e së cilave priste më keq se shpata.

167. Mihailo Mihailov, disident i njohur jugosllav: Mbatja e Adem Demaçit 28 vjet në burg nuk ka logjikë

Kur kam ardhur në Burgun e Pozharevcit, në vitet 1967 dhe 1968, kam qenë në të njëjtin pavijon me Adem Demaçin. Aty kemi zhvilluar biseda të pafundme. Në atë kohë ishte dogmatik total, por, po e shoh, sipas intervistave, se nuk është më i tillë. Po dëgjoj se po e thërrasin "Mendela i Kosovës". I ka kaluar i gjori 28 vjet në burg! Është e habitshme pse e kanë mbajtur. Mendoj se aty nuk ka logjikë.

168. Mikel Sopi, klerik i kishës katolike: Udhëheqja e Adem Demaçit të KMDLNJ-së arriti angazhimin e rreth 2000 anëtarëve në Këshill

Në pranverë të vitit 1991 Adem Demaçi merr kryesinë e Këshillit

për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut në Prishtinë. Me ardhjen e tij në krye të Këshillit, nga një kolektiv prej gjithsej 25 vullnetarësh, së shpejti Këshilli hapi shumë degë në Kosovë dhe jashtë vendit duke arritur numrin prej rreth 2000 anëtarësh.

169. Milazim F. Kadriu, publicist: Adem Demaçi ishte dhe mbeti flamurtar

Adem Demaçi ishte dhe mbeti Flamurtari, Udhëheqësi dhe Sinonimi i përhershëm dhe emblematik i luftës dhe të gjitha përpjekjeve tjera çlirimtare dhe patriotike të kombit dhe atdheut tonë të përbashkët.

170. Milosh Mishoviç, historian: Adem Demaçi, nacionalist dhe separatist i njohur

Organizata "Lëvizja Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve", në krye të së cilës ishte juristi i padiplomuar dhe shkrimtari Adem Demaçi, është zbuluar nga fundi i vitit 1963 dhe fillimi 1964. Në të vërtetë, ky ishte konfrontimi i dytë i Demaçit me ligjin. Ky nacionalist i njohur dhe separatist për herë të parë është zbuluar në vitet e pesëdhjeta si udhëheqës i organizatës ilegale "Lëvizja Revolucionare Antirevizioniste", e cila kishte vepruar në rrethin e Prishtinës dhe Podujevës, qëllimi i së cilës ishte bashkimi i Kosovës me Shqipërinë.

171. Muhamet Koci, gazetar: Baca Adem Demaçi deklaroi: "Gjatë vizitës së kryeministrit Edi Rama në Serbi ai është sjell si burrshtetas i vërtetë"

Baca Adem Demaçi, duke folur për vizitën e kryeministrit Edi Rama në Serbi, ka thënë: "Edi Rama, gjatë vizitës në Beograd, është sjellë si burrshtetas i vërtetë. Paraqitja e Ramës përballë Vuçiqit ka qenë pa ndjenja inferioriteti dhe pa ndonjë vërejtje. Pas kësaj vizite Serbia duhet ta kuptojë se shqiptarët dhe Shqipëria janë plotësisht të barabartë me serbët dhe Serbinë".

172. Muhamet Mavraj, botues i gazetës "Epoka e re": Adem Demaçi hyri në politikë për t'i dhënë asaj e jo për të marrë nga ajo

Adem Demaçi është nga ata tipat ideal të politikanëve të Max Weberit që në politikë hyjnë për t'i dhënë asaj dhe jo për t'i marrë. S'njoh edhe një njeri më të ndershëm se Adem Demaçi kur i mendoj gjithë ato që mund t'i ketë për vete dhe i përbuzë. Jam me fat që i takoj kombit të tij.

173. Muhamet Pirraku, historian: Adem Demaçi, përjetësisht eci vertikalisht

Adem Demaçi u krijua, u fërgua dhe u farkëtua në dhjamin e vet, me ndërjegjen ekzemplar, për

t'u ardhur si udhërrëfyes dhe mësues Brezave të lirisë shqiptare. Bacë eci përjetësisht vertikalisht.

174. Muhamet Rogova, veprimtar i çështjes kombëtare: Adem Demaçi, themelues i organizatës "Lëvizja Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve"

Thirrjes që lëshoi Adem Demaçi në vitin 1963, si themelues i organizatës "Lëvizja Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve", iu bashkuan me qindra intelektualë atdhetarë gjithandej Kosovës. Kështu, për një kohë shumë të shkurtër, organizata formoi Degët e saja në Prishtinë, në Mitrovicë, në Pejë, në Gjakovë, në Gjilan, në Shkup dhe në Stamboll.

177. Murat Jashari, pinjoll i familjes historike Jashari nga Prekazi: Adem Demaçi, margaritar i kombit tonë

Adem Demaçi është margaritar, dhe margaritari, siç do të thoshte Sami Frashëri, mbetet margaritar edhe kur duket i prerë shtrembër. Nga Bacë Adem Demaçi kemi çka mësojmë edhe sot prej tij dhe shumë do të mësojnë, nesër, gjeneratat që do të vijnë pas tij.

178. Murteza Nura, bashkëveprimtar i Adem Demaçit: Adem Demaçi, njeri i vetëflijimit me vetëdije

Adem Demaçi dhe bashkëveprimtarët e tij ishin individë me moral të lartë, që u pagëzuan si njerëz të dritës, u vetëflijuan me vetëdije. Këta e

Juve, Bacë Adem Demaçi, ju kishim në shpirt e në zemër edhe atëherë kur dirgjeshit në kazamatet e ish-Jugosllavisë, mirëpo mbetët në zemrat tona edhe sot, kur jeni të rrethuar me shkrimtarë, poetë, gazetarë e intelektualë të tjerë nga Kosova në grevën e urisë dhe në grevën e përgjithshme kundër shkallëzimit të armiqësisë famëkeqe çetnike të Beogradit.

181. Mustafë Statovci, gazetar: Adem Demaçi bëri jetë të pandërprerë patriotike, si brenda si jashtë burgut

Pesëdhjetë e tetë vjet nga jeta e këtij burri, Adem Demaçit, të ndara më dysh, prej të cilave gjysmën i bëri matanë e gjysmën tjetër këtej grilave, ecën e vazhdu-



175. Mujë Berisha, veprimtar i çështjes kombëtare: Adem Demaçin e vlerësoi Parlamenti Evropian me Çmimin "Saharov" Duke e vlerësuar veprimtarinë e Adem Demaçit, Parlamenti Evropian, më 12 tetor 1991, e dekoroi në Strasburg me Çmimin "Saharov". Po kështu, Klubi Evropian i Rektorëve të Universiteteve të Evropës i dha Çmimin special për paqe kundër racizmit e ksenofobisë.

176. Mujë Rugova, rektor i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina": Adem Demaçi është pjesë e pandashme e historisë së Kosovës

Adem Demaçi është pjesë e pandashme e historisë më të re të Kosovës. Adem Demaçi është shembulli më unik i cili ka rrezatuar fuqi të jashtëzakonshme të ndikimit politik e atdhetar në kohën kur pjesën më të madhe dhe më vitale të jetës e ka kaluar në qelitë e burgjeve jugosllave.

ndezen pishtarin e lirisë dhe e mbajtjen me dinjitet të mos shuhet, për të ecur e për të ndriçuar rrugën nëpër tunelin e errët që kishte hapur armiku për ta, dhe dolën faqebardhë matanë tij.

179. Musa Haxhiu, dekan i Fakultetit të Mjekësisë të UP-së: Demaçi dhe Saharovi sakrifkuan për Hmanitetin, Lirinë dhe Drejtësinë

Adem Demaçi është viktima më tragjike e bolshevizmit në Jugosllavi. Është simbol i rezistencës paqësore dhe demokratike për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut në Jugosllavi. Një pikë e përbashkët që e lidhë Demaçin me Saharovin, janë sakrificat e tyre për Humanitetin, Lirinë dhe Drejtësinë.

180. Musa Hoti, veprimtar i dalluar i çështjes kombëtare: Juve, Bacë Adem Demaçi, ju kishim në shpirt e në zemër

an të ecin nëpër disa binarë paralelë: aktiviteti i pandërprerë politik e patriotik brenda dhe jashtë burgut.

182. Mustafë Xhemajli, shkrimtar: Adem Demaçi, institucion moral i shqiptarëve

A mjafton vetëm ta përshkruajmë punën e Adem Demaçit, a mjafton vetëm të konstatojmë, vazhdimisht, në stilin: Adem Demaçi është... Apo duhet bërë më shumë, për të shkruar librin e plotë, apo përafërsisht të plotë, për këtë institucion moral të kombit tonë.

183. Myrvete Dreshaj-Baliu, shkrimtare: Biografia e Adem Demaçit shihet në shumë aspekte dhe paradigma

Në rrethanat e sotme biografia historike e Adem Demaçit shihet në shumë aspekte dhe paradigma e saj shkon nga ideologjia te historia, nga tradicionalja dhe etnografia te prejardhja sociale dhe nga kujtesa historike te synimet e saj. (Vijon)

Telegram ngushëllimi ALI AHMETIT PËR ABDILHAQIM ADEMIN

Telegram ngushëllimi udhëheqësit të popullit shqiptar, Ali Ahmeti, me rastin e ndarjes nga jeta të personalitetit të shquar të BDI-së e të shtetit të Maqedonisë.



Ismet SYLEJMANI

I dashur dhe shumë i nderuar shoku dhe miku im i madh Ali Ahmeti,

Lajmi i kobshëm, se ka pushuar së rrahuri zemra e shokut dhe bashkëpunëtorit tuaj më të ngushtë, sekretarit të përgjithshëm të BDI-së, shefit të Shtabit Zgjedhor të BDI-së në disa zgjedhje partiake, e

Abdilhaqim Ademit është e dhembshme sepse pushoi së rrahuri zemra e një shqiptari besnik, i cili në momente dramatike jo vetëm nuk jepej e nuk dorëzohej, por qëndronte stoik e i palëkundur, nuk tundej përpara asnjë presioni e asnjë shantazhi ngado që i vinte. Për neve shokët dhe bashkëpunëtarët e udhëheqësit të popullit shqiptar Ali Ahmeti, ikja dhe ndarja nga kjo jetë e Abdilhaqim Ademit është dhembje e rëndë, është goditje e drejtpërdrejtë, se u humb shoku e miku i madh, shoku e bashkëpunëtor i më i madh e më i ngushtë i kryetarit të BDI-së.

Si ka mundësi të mos jemi të

figura e madhe e politikanit shqiptar jo vetëm në Maqedoni, që u angazhua dhe dha maksimumin për prosperimin e gjithanshëm të popullit shqiptar në Maqedoni.

Si asnjë tjetër personalitet, shqiptari Abdilhaqim Ademi dëshmoi katërcipërisht, se kush bashkëpunon ngushtë e në mënyrë besnike e parimore me udhëheqësin Ali Ahmeti, nuk i mungojnë sukseset dhe se mbetet përgjithmonë figurë e madhe e kombit, atdheut dhe e popullit shqiptar.

Politikanët e ardhshëm të BDI-së e të popullit shqiptar në Maqedoni duhet ta ndjekin shembullin e këtij burri të nderuar e të politikanit atd-



zëvendëskryeministrit të Maqedonisë, ministrit të Arsimit dhe Shkencës të Maqedonisë, ministrit të Ambientit të Maqedonisë, por edhe bartësit të shumë funksioneve relevante e organizatorit të talentuar e me autoritet, mikut tim Abdilhaqim Ademi, na ka shkaktuar shumë dhembje e shumë hidhërim; na ka ndalur frymën!

Dhembja për vdekjen e hershme të Abdilhaqim Ademit është e madhe, ngaqë u humb një burrë i madh e i shquar, një shqiptar i devotshëm, një njëri me qëndrime të qarta e parimore.

Ndarja nga kjo jetë e

mërzitur e të mos jemi të tronditur nga dhembja, kur kujtojmë se ka ndërruar jetë dhe më nuk është në mesin tonë, në mesin e të gjallëve, ai shqiptari i madh Abdilhaqim Ademi, që e ka përjetuar atentatin e tmerrshëm në veturë bashkë me Ali Ahmetin e shoqëruesin besnik të Aliut, Shefik Ismailin. Ishte Abdilhaqimi Ademi ai që i ishte bërë mburojë e gjallë udhëheqësit të popullit shqiptar, Ali Ahmeti.

Kishte qenë në gjendje që edhe me trupin e vet t'i bëhej mburojë e gjallë, që të mos e kapnin plumbat e atentatorëve kriminelë.

Abdilhaqim Ademi mbetet

hetar të përkushtuar, se si duhet të jenë besnikë deri në vdekje ndaj kauzës së shenjtë të popullit që i takojnë dhe udhëheqësve të mëdhenj që u qëndrojnë përkrah pa iu trembur syri.

Edhe një herë i nderuar shoku e miku im Ali Ahmeti, ngushëllime për vdekjen e Abdilhaqim Ademit, dhe nëpërmjet jush, shpreh ngushëllimet e mia familjes së Abdilhaqimit dhe gjithë popullit shqiptar në Maqedoni!

Lamtumirë miku im Abdilhaqim Ademi!

Të qoftë i lehtë dhe i tokës së atdheut!

Prishtinë, 17 shkurt 2018

Rusia mohon ndërhyrjet në zgjedhjet amerikane

Pasi prokurori i posaçëm amerikan Robert Muller akuzoi 13 shtetas dhe tri organizata ruse se kanë kryer një "betejë të paligjshme informacioni" me qëllim prishjen e procesit zgjedhor dhe për ta ndihmuar Donald Trumpin të fitojë, Kremlinin mohoi të hënën përfshirjen e Qeverisë ruse në zgjedhjet presidenciale amerikane të vitit 2016



MOSKË, 19 SHKURT - Kremlinin mohoi të hënën përfshirjen e Qeverisë ruse në zgjedhjet presidenciale amerikane të vitit 2016. Zëdhënësi Dmitri Peskov u tha gazetarëve se akuzat janë të pabaza. Komentet vijnë disa ditë pasi prokurori i posaçëm amerikan Robert Muller akuzoi 13 shtetas dhe tri organizata ruse se kanë kryer një "betejë të paligjshme informacioni" me qëllim prishjen e procesit zgjedhor dhe për ta ndihmuar Donald Trumpin të fitojë. Në aktakuzë pretendohet se këto përpjekje janë orkestruar prej 12 punonjësve të Agjencisë së Kërkimeve në Internet, me bazë në Shën Petersburg dhe e lidhur me Kremlinin dhe prej garantit të saj financiar. Dokumenti prej 37 faqesh pohon se komplotistët rusë u përpoqën t'i bashkërendonin përpjekjet e tyre me zyrtarë të fushatës së Trumpit, por ndaj

këtyre të fundit nuk ngrihet asnjë akuzë për bashkëpunim të fshehtë me rusët. Për një kohë të gjatë Trumpi ka këmbëngulur se njerëzit e fushatës së tij nuk kanë bashkëpunuar me Rusinë. Komuniteti amerikan i zbulimit dhe tashmë Mueller kanë arritur në përfundimin se Rusia zhvilloi një fushatë të gjerë për të ndërhyrë në zgjedhjet për ta ndihmuar Trumpin të fitojë. Kjo është hera e parë që zyra e Muellerit ngre akuzat kundër shtetasve dhe organizatave ruse për ndërhyrje në zgjedhjet e vitit 2016. Të dielën në një seri komentesh në "Twitter" presidenti Trump sulmoi hetimet e ndryshme që po kryhen nga Robert Mueller dhe komisionet e Kongresit amerikan. Trumpi sulmoi FBI-në dhe ligjvënësit që hetojnë ndërhyrjen e dyshuar të Rusisë në zgjedhjet presidenciale në

ShBA, më 2016, duke thënë se ata janë përqendruar së tepërmi te Rusia dhe kanë humbur shenjat që mund të kenë parandaluar të shtënat vdekjeprurëse në Florida. Trumpi tha se hetimet e Kongresit dhe "urrejtja politike" treguan se Rusia ka arritur të mbjellë grindje, përçarje dhe kaos në ShBA. Ai tha se paraardhësi i tij, Barack Obama, ka dështuar të bëjë mjaftueshëm për ta ndaluar ndërhyrjen e Rusisë në zgjedhjet. Në njërin nga postimet në "Twitter", Trumpi kritikoi FBI-në për neglizhimin e shenjave paralajmëruese në rastin e 19 vjeçit Nikolas Cruz, i cili është akuzuar për vrasjen e 17 personave më 14 shkurt në një shkollë në Parkland të Floridas. FBI ka pranuar të premten se ka dështuar të hetojë një paralajmërim se Cruzi ka armë dhe dëshirë për të vrarë.

LAJME SHKURT

Trumpi tërhiqet për armët, kërkon kontrollë më të rrepta


WASHINGTON, 19 SHKURT - Presidenti amerikan Donald Trump ndryshon qëndrim sa i përket kontrolleve lidhur me armët, në vazhdim të masakrës në shkollën e mesme të Floridës. Zëdhënësjja e tij, Sarah Huckabee Sanders, sqaroi se presidenti i mbështet përpjekjet që synojnë ta bëjnë më të vështirë blerjen e armëve nga kriminelët. Sipas Shtëpisë së Bardhë, numri një i Uashingtonit kishte biseduar me senatorin republikan, John Corny, dhe kolegun e tij demokrat, Chris Murphy, lidhur me një projektligj konsensual të prezantuar prej tyre që do të detyrojë shtetet dhe agjencitë federale të raportojnë më shpesh akuzat, që do të pengonin një individ të blinte armë zjarri. Nisma pason raportimet se, vrasësi i dyshuar i 17 personave në shkollën e mesme të Parklandit, në Florida, e kishte blerë në mënyrë të ligjshme armën e tij. Trumpi, i cili ka qenë një mbështetës i fortë i së drejtës për të zotëruar armë, u kritikua ashpër për reagimin fillestar ndaj tragjedisë në shkollë.



Në një postim në "Twitter", ai tha se u përcillte ngushëllimet dhe lutjet familjarëve të viktimave, duke nxitur komentet e ashpra të disa studentëve që i kërkuan atij të bënte diçka, në vend që të lutej. Nxënësit që i mbijetuan sulmit në Parkland u zemëruan edhe pas deklarimit të presidentit, të dielën, kur ai e lidhi dështimin e FBI-së në adresimin e paralajmërimeve për të dyshuarin 19-vjeçar, Nikolas Cruz, me angazhimin e ekzagjeruar të saj në hetimin mbi Rusinë.

Irani refuzon kontrollin e jashtëm mbi programin e tij raketer

MOSKË, 19 SHKURT - Teherani nuk do ta vendosë programin e tij të raketave nën kontroll ndërkombëtar, tha në Moskë ministri i Jashtëm i Iranit, Mohammad Javad Zarif. Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, ka kërcënuar se do të tërhiqet nga marrëveshja bërthamore e vitit 2015 midis Iranit dhe gjashtë fuqive botërore, nëse Republika Islamike nuk ndalon zhvillimin e raketave balistike. "Pse duhet ta bëjmë këtë", tha Zarifi pasi u pyet nëse Irani është i gatshëm të pranojë monitorimin e jashtëm mbi programin e tij raketer.



Me marrëveshjen e vitit 2015, Irani ka rënë dakord të frenojë aktivitetin e tij bërthamor në këmbim të lehtësimit të sanksioneve ndërkombëtare. "Presidenti amerikan ka ambicie të mëdha, por ato nuk do të bëhen kurrë realitet", tha Zarif, i cili ndodhet në Moskë për takimin e Klubit Valdai të Diskutimit - një mbledhje e ekspertëve të politikës së jashtme ruse dhe ndërkombëtare. Zarifi, po ashtu, kritikoi mbështetjen e Shteteve të Bashkuara për forcat kurde siriane, të cilat kundërshtojnë Qeverinë e presidentit sirian Bashar al-Assad.

Vandalizohet ambasada polake në Izrael

TEL-AVIV, 19 SHKURT - Vandalët vizatuan shenjën e kryqit të thyer nazist në dyert e Ambasadës polake në Tel-Aviv, një veprim që pason komentet e ditëve të fundit nga kryeministri polak Mateusz Morawiecki në të cilat ai përdori shprehjen "keqbërësit hebrej" të Holokaustit. Vandalët vendosën mbishkrime me të shara në dyert e Ambasadës polake në Izrael. Policia tha se kanë nisur një hetim mbi incidentin dhe është në kërkim të të dyshuarve. Izraelitët janë të zemëruar me një

ligj të ri në Poloni që dënon këdo që e quan gjenocidin nazist një krim polak. Polemika shpërtheu të shtunën kur një gazetar në Konferencën e Sigurisë në Mynih e pyeti kryeministrin polak Morawieckin nëse ai mund të burgoset për tregimin e historisë se si fqinjët e familjes raportuan nënën e tij të nazistët në Poloni. Udhëheqësit izraelitë dënuan menjëherë komentin e udhëheqësit polak. "Ne jemi të bashkuar në këtë luftë. Duhet të jemi të fortë për kuj-

timin e vëllezërve dhe motrave tonë të vrarë në Shoah. Por sot, më shumë se kurrë, duhet të punojmë për të arsimuar botën, madje edhe disa nga udhëheqësit e saj, për atë kohë të errët", tha presidenti izraelit, Reuven Rivlin. Zëdhënësi i kryeministrin polak Morawiecki tha se ai në asnjë mënyrë nuk ishte përpjekur ta mohonte Holokaustin. Rreth gjashtë milionë polakë, gjysma prej tyre hebrej, u vranë gjatë Luftës së Dytë Botërore nga nazistët.



Zyra e kryeministrin izraelit, Benjamin Netanjahu, tha se ai kishte zhvilluar një bisedë telefonike me homologun e tij polak të

dielën, duke i thënë atij se "krahasi-mi i aktiviteteve të polakëve me ato të hebrejve gjatë Holokaustit është i pabazuar".

NJË SHTATORE PËR ADEM DEMAÇIN

- Vështrim mbi librin e porsadalë nga shtypi, "Demaçi - njeri i lavdisë", të autorit Selatin Novosella



Lulëzim ETEMAJ


Një shtatore për Bacën. Ky ishte mendimi i parë që më është sjellë në kokë porsa autori Sabri Novosella më ka treguar rreth librit "Demaçi - njeri i lavdisë", të cilin tashmë ishte duke e përfunduar, në takimin e parë fizik të fillimjanarit që kam pasur me të e që si shkak kishte, sërish, pikërisht Bacën Adem. Dhe, pas leximit që i kam bërë dorëshkrimit të librit, jam ndër të shumtë i kënaqur që më është konfirmuar tërësisht

mendimi fillestar. Jam ndër të kënaqur sepse e ndaj mendimin që Baca Adem, lexuesit në përgjithësi, veçanërisht ihtarët e tij, të të gjitha kategorive, e meritojnë një libër të tillë të veçantë. Nga ky libër do të përfitojnë shumë edhe studiuesit shkencorë, të vjetër e të rinj, të jetës dhe veprës, me përmasa shumëdimensionale të jashtëzakonshme, të Demaçit.

Ky libër është një shtatore, krejt unikate, për Bacën Adem. Një nga të veçantat e saj, mbase edhe me ndikim vendimtar në jetëgjatësinë e saj, duke qenë se ne shqiptarët vazhdojmë të mos shquhemi gjitha për kujdesin ndaj të gjallëve, përfshirë edhe heroin Adem Demaçi, e lëre më për shtatoren e ngritura rrugëve dhe sheve, të cilat fare lehtë në një ditë të afërme edhe mund të përmbysen përtokë si pasojë e

vetmisë, qëndron në faktin se kjo shtatore do të bartet nga lexuesit gjithandëj ku ata do të frymojnë.

Një shtatore që për autor ka 299 persona, me e pa funksione shtetërore, të lëmvive dhe profesioneve të shumta, madje edhe pa profesione fare, por që janë angazhuar në cilësinë e bashkëveprimtarëve apo dhe ish bashkëvuajtësve politikë të Bacës Adem. Dhe, në mesin e këtyre 299 bashkautorëve të Selatin Novosellës ka shqiptarë, amerikanë, gjermanë, francezë, kroatë, slovenë..., madje edhe serbë, të cilët, me fjalët e tyre, me një ndjesi të hollë kanë ndërnuar, gdhendur dhe nxjerrë në sipërfaqe për lexuesin anët më të shndritshme të Adem Demaçit, duke i bërë shumë konkrete përmasat e tij si njeri, veprimtar shembull i të drejtave universale njerëzore dhe kombëtare, simbol frymëzimi për breza të tëra shqiptarësh liri dhe bashkim kombëtarësh, hero me përmasa krejt tokësore që mendon me kokën e tij, e thotë atë çfarë mendon pa për-



logaritum çmimin, shkruan dhe lëron kujdesshëm fjalën, duke e bërë të bukur, artistike, fjalë që shquhet për nga porosia direkte.

Kjo shtatore e Demaçit, njeriut antidogmë, vërtet do të ishte në masë bukur të madhe abstrakte për lexuesit e librit, njohësit e Demaçit, sikur autori të mos ia jepte edhe atij fjalën, sado që krejt shkurt, për të na folur, përmes medimeve të ndryshme, si askush tjetër, siç

flet vetëm Ai, për procese të caktuara politike në Kosovë.

Një shtatore për Demaçin, kur nuk flet Demaçi, s' mund të jetë tjetër veçse një antishtatore! Këtë do ta ketë pasur parasysh, dhe gjithsesi edhe ia ka arritur qëllimit për t'i ikur grackës, autori i librit, Selatin Novosella, i cili pas vetës ka mbi gjysmë shekulli të kaluar me e pranë Bacës Adem.

Përderisa për Demaçin aksioma "E para ishte fjala", ishte shndërruar në parim dhe në yll polar të rrugëtimit jetësor, për lirinë e së cilës, si kryefjalë e të të drejtave universale të njeriut, ishte në gjendje ta sakrifikohte veten në çdo çast, për t'u ringritur në këmbë edhe më fuqishëm, si një feniks i vërtetë, për ririnë patriotike shqiptare të Shqipërisë agolliane të përtej dritit, i pari ishte Demaçi.

Kënaqësi e veçantë kur e ndesh në librin "Demaçi - njeri i lavdisë" edhe faktin, se Demaçi nuk ishte i pari vetëm për ririnë shqiptare, por i tillë cilësohet edhe nga gjeneratat e tjera, brenda e jashtë shqiptare.

Rexhepi: Sali Ramadani, sinonim i guximit, dijes dhe atdhedashurisë

Milazim F. KADRIU

Nën organizim të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, me kryetar Abaz Osmani, në Institutin Albanologjik në Prishtinë është mbajtur tubim përkujtimor për Sali Ramadani, deputeti shqiptar i cili në vitin 1997 shpалosi flamurin kuq e zi në Parlamentin e Maqedonisë.

Sali Ramadani ka lindur në vitin 1939 në Kërçovë. Ai ishte një protagonist i politikës në Maqedoni në periudhën nga mesi i viteve '90 si deputet i PPD-së, më vonë i PDSH-së në Parlamentin e Maqedonisë.

Më 8 korrik të 1997 nga foltorja e Parlamentit të Maqedonisë nxori flamurin kombëtar shqiptar dhe e shpалosi në sallën e Parlamentit. Një pjesë e madhe e mediave dhe ekspertëve maqedonas për çështje juridike, që edhe sot janë protagonistë aktualë në politikë, kërkuar arrestimin e tij.

Kryetar i parlamentit ishte socialdemokrati Tito Petkovski, i cili reagoi ashpër, duke kërkuar ndërhyrjen e shërbimeve për heqjen e deputetit Ramadani nga foltorja.

Ai ka ndërruar jetë më 27 janar 2018, ndërsa LKSh-ja me një

tubim përkujtimor nderoi jetën dhe veprën atdhetare të Sali Ramadani.

Duke folur para të pranishëmve në këtë takim përkujtimor Sadri Rexhepi, ndër të tjera, tha: "Sali Ramadani - Kërçova njihet si veprimtar i devotshëm i çështjes shqiptare, sinonim i guximit, dijes dhe atdhedashurisë, i burgosur dhe i përndjekur nga pushteti që nga moshë studentore e deri në vitet e pluralizmit. Aktiviteti i tij politik ka filluar që në moshë të re, por ai intensifikohet në vitin 1968 me kandidimin për deputet të zonës, ndërsa një vit më vonë burgoset pas një procesi gjyqësor në cilin ai deklaroi politikën anti-shqiptare duke mbetur i palëkundur në qëllimet e veta, i guximshëm dhe energjik në veprime edhe përkundër presioneve të mëdha që pushteti monist i bënte në vazhdimësi", ka thënë Rexhepi.

Për të shtuar se pas vitit 1981 Sali Ramadani - Kërçova bën një aktivitet të ngjeshur ilegal për sensibilizimin dhe mobilizimin e popullit shqiptar në kuadër të organizatës "Besëlidhja për çlirim kombëtar". "Pas viteve '90 ai kthehet në vendlindje dhe jep kontributin e tij në proceset politike që do të pasonin. Opinioni i



gjerë tashmë e ka të njohur veprimtarinë e tij parlamentare dhe veprimet konkrete për të drejtat e shqiptarëve, siç ishte shpалosja e flamurit tonë kombëtar në foltoren e Parlamentit të Maqedonisë më 8 korrik 1997", ka thënë ai.

Më tej, Rexhepi ka theksuar se Sali Ramadani, pas luftës së fundit shqiptaro-serbe dhe shqiptaro-maqedone, u mor kryesisht me shkrime dhe angazhohej për grumbullimin dhe botimin e atyre shkrimeve që i kishin ndaluar për 30 vjet me radhë. "E sot kur Kosova frymon lirshëm

pas dhjetë vjetësh pavarësisë nga robëria shekullore serbosllave, po shkojmë drejt plotësimi të idealeve, synimeve dhe qëllimeve të përhershme të Sali Ramadani. Të gjitha këto na detyrojnë të çmohim, ta nderojmë e ta përkujtojmë me pietet të lartë këtë veprimtar të palodhshëm, punëtor e luftëtar të denjë të çështjes e të çlirimit kombëtar", ka deklaruar Rexhepi. Ndërsa Hydajet Hyseni ka folur për rolin dhe kontributin e ish të burgosurve politikë shqiptarë gjatë periudhave të ndryshme, në veçanti për rolin dhe kontributin e veprimtarit Sali Ramadani që

për veprimtarinë e tij atdhetare ishte burgosur disa herë nga ish-sistemi monist.

Në emër të familjarëve, motra Nexhbedije i ka përshëndetur të pranishmit, kurse organizatorët i ka falënderuar për këtë tubim në nderim të jetës dhe veprës së Sali Ramadani.

Abaz Osmani, në emër të LKSh-së, për kontributin e dhënë për çështjen kombëtare i ndau mirënjohje veprimtarit tashmë të ndërjet Sali Ramadani - Kërçova. Mirënjohjen e pranoi Zylbije Ramadani, bashkëshortja e Sali Ramadani.

Angelina Jolie shkëlqen në ceremoninë e çmimeve BAFTA



Në ceremoninë e çmimeve BAFTA të pranishme ishin artiste të njohura, të cilat shkëlqyen gjatë parakalimit në tapetin e kuq. Disa nga aktoret e njohura kishin zgjedhur sërish


ngjyrën e zezë në veshjen e tyre. Veshjet në ngjyrë të zezë të zgjedhura nga artistet ishin në mbështetje të lëvizjes "Time's up". E veshur me fustan të zi dhe të gjatë, Angleina Jolie u prit mjaft mirë nga fansat.

Liam Payne dhe Cheryl ndahen?



Marrëdhënia midis dy këngëtarëve të famshëm Cheryl dhe Liam Payn mesa duket po shkon drejt fundit. Ata janë lidhur së bashku në vitin 2016 dhe kanë një djalë të vogël së bashku, Bearin, i cili mbush një vjet. Por, më pak se një vit

pas ardhjes së tij në jetë, marrëdhënia e çiftit thuhet se është e tendosur për shkak të presioneve për menaxhimin e orareve të ngarkuara të punës. Një arsye mendohet të jetë karriera e ish-yllit të One Direction, Liam, që dëshiron të bëjë një tur botëror.



Rita Ora madhështoi festën e pavarësisë së Kosovës

Rita Ora u kthye në Kosovë për ta festuar 10-vjetorin e pavarësisë së Kosovës dhe nuk i zhgënjeu bashkatdhetarët. Këngëtarja e famshme ofroi një performancë të jashtëzakonshme në

koncertin e zhvilluar në Prishtinë mbrëmjen e së shtunës. Me një kostum kuqezi të ngushtë, 27-vjeçarja këndoi hitet e saj më të njohura dhe kërceu pa u lodhur për kënaqësinë e publikut të shumtë.

Khloe Kardashian bëhet nostalgjike



Khloe Kardashian ka pohuar se periudha e shtatzënisë nuk është më e lumtura për të për shkak të përmasave që ka marrë trupi i saj. Bukuroshja Kardashian duket se është bërë nostalgjike për linjat e saj

trupore përpara shtatzënisë, të cilat ishin të mahnitshme. Në rrjetin social "Instagram" ylli i televizionit ka publikuar disa fotografi në të cilat shfaqet me veshje të bardhë dhe flokët e mbledhura bisht.



| EPOKA ERE | | | | | | Autor: GAZMEND MORINA | KËNGËTARJA SHQIPTARE NË FOTO | SECILA NGA PJESET QË FORMOJNË NJË TË TËRË | POLITIKANI ITALIAN KHANFRANKO | SEND QË PËRDORET PËR TË LUAJTUR (shq.) | "T" në mes të dy "E" | BASHKËT. | SOKOL BASHOTA | EPOKA ERE | TË FIKËT | ARMË GJAHU ME NJË TYTË DHE ME FISHEKË SI TË ÇIFTES | OLIVER NEUVILLE | |
|------------------|--|--|--|--|--|------------------------------------------------------------|------------------------------|-------------------------------------------------------|-----------------------------------------------|----------------------------------------|------------------------------------------------------|----------|----------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------|----------------------------------------------------|----------------------------------------|--------------------------|
| EPOKA ERE | | | | | | VEPRIM I VETVETISHËM DHE I MENJ-ËHERSHËM | | | | | | | | PËREMËR VETOR FUTBOLLISTI BAJRAMI | | | | |
| EPOKA ERE | | | | | | KONGRESMEN I AMERIKAN ENGEL | | | | | | | AKTORJA DHE MODELJA RODRIGUEZ SPORTIST QË MERRRET ME NOT | | | | | |
| EPOKA ERE | | | | | | ISH FUTBOLLISTI HOLANDEZ BOUDEWIJN | | | | | | | SHOK, JARAN LECCE | | | | SHKRIMTARI KELMENDI | |
| EPOKA ERE | | | | | | EMËR MASHKULLI MYSLIMAN | | | | | REGJISORI I FAMSHËM STONE RIFAT KUKAJ | | | | | | | |
| EPOKA ERE | | | | | | RENIUM | | TË BUKURIT (pashq.) ELEMENT KIMIK (TA) | | | | | RAMADAN AVDIU EMËR YNI MASHKULLI | | | ZANORE GOJËTAR | | |
| EPOKA ERE | | | | | | ROK BEND I YNI | | | | DREJTIM QËLLIM I PARAMEND- UAR | | | | LIGJ, KANUN (vjet.) NJË PLANET | | | | |
| EPOKA ERE | | | | | | SULM, MËSYMJE | | | | | KORNIZË TUNDEM, LËKUNDEM, SHKUNDEM ME FORCË | | | | "RIZONI" FUTBOLLISTI YNË ZEJNULLAHU | | | |
| EPOKA ERE | | | | | | FILM I REGJISORIT ISA QOSJA | I EMËROVA NË NJË DETYRË | THIKË QË MBAHEJ SI ARMË BREZI (sh.shq.) | NEGRI, ZEZAK | KËSTI BANKAR | BINARËT E TREMIT ZANORE | | | DOLLAP I VOGËL PËR TË MBAJTUR ZOGJ | | | | |
| EPOKA ERE | | | | | | BIMË QË BËN KOKRRA TË VOGLA E QË HAHEN | | | | | TERMINATE STAY RESIDENT QË RUHET NGA DIKUSH; I | | | PASURI E PATUNDSHME QË SILLTE TË ARDHURA DEM, KA | | | | QË PËRSHKOHET NGA PATOSI |
| EPOKA ERE | | | | | | RRETHI QË VIHET NË GISHT I STOLI ARI | | | | | | | | SHENJË NDALESE BËSNIK (perkdh.) | | | | |
| EPOKA ERE | | | | | | KRYENGRITËS QË DILTE MALIT E LUFTONTE PËR LIRINË E ATDHEUT | | | | | | | | | NJËSI KOHE KËNGËTARJA E FAMSHME FRANKLIN | | | |
| EPOKA ERE | | | | | | AKTORJA E SHQUAR THURMAN | | REGJISORJA KALLABA VENDLINDJA E ODISEUT | | | AKTORI MORINA BANOR I NJË SHTETI AZIATIK | | | | | | TOTENHAM 365 DITË | |
| EPOKA ERE | | | | | | GOJËDHËNA | | | PEMË E VENDEVE TË NGRORHTA E QESHURA TALLËSE | | | | KADRI ROSHI I KORR | | | PRODUKT I PULËS TËRËSI E ORENDIVE | | |
| EPOKA ERE | | | | | | INDIUM | | REGJISORI AMERIKAN ... BURTON NJË PIJE ALKOOLIKE | | | NDËRRIMI I MALLIT (krah.) KALJARI | | | | ALBANOLOGIA ... DURHAM LETRARI ... ASLLANI | | | |
| EPOKA ERE | | | | | | VEZAK SHTET FEDERAL NË SHBA | | | | | LAJM HAP BRUMIN ME PETËS | | | SECILA NGA DY BRINJËT E NJË TREKËNDËSHI BIMË QË PËRDORET SI USHQIM (sh.shq.) | | | | |
| EPOKA ERE | | | | | | JURIST QË JEP NDIHMË E KËSHILLA PËR ÇËSHTJE TË DREJTËSISË | | | | | NOTË MUZIKORE FUQI, FORCË | | | BANOR I NJË SHTETI TË MADH EVROPIAN FIGURË SHAHU | | | BASHKËT. KRITERE | |
| EPOKA ERE | | | | | | RADIOLOK-ATORËT | | | | | PËRÇARJE BASHKËT. | | | | OHAJO, PENSILVANIA TOKË E BUKËS (sh.shq.) | | KONFERENCË ME KARAKTER NDËRKOMB-ËTAR | |
| EPOKA ERE | | | | | | ZANORE | | KORÇA REPERI I FAMSHËM DOGG (shqip.) | I ÇEL | | | | | NËPËR ARA, ARAVE VAJ KËZHINE QË PRODDOHET NË SHQIPËRI | | | | |
| EPOKA ERE | | | | | | ZEN SUPPLIERS AUTOMOTIVE | | | BASHKË, ME (bised.) KËMBËZ SHKALLË, SHKALLARE | | DILETANT ZET, RENIUM | | | | | RESHAT ARBANA AKTORJA E FAMSHME AMERIKANE RICHARDS | | |
| EPOKA ERE | | | | | | OLIVIA NORMAN | | POPULL QË KA BANUAR NË PELLGUN E EGJEUT (hist.) SELEN | | | | | | LAKESË KAM DIJENI PËR DIÇKA | | | | |
| EPOKA ERE | | | | | | FEMRAT E PORSAMARTUARA | | | | | | | | | | | | |
| EPOKA ERE | | | | | | OREKS | | | | | | | | | | | AKTORI HOLLYVUDIAN ... DAMON (perkdh.) | |

E jashtëzakonshme

Studenti i pazakontë

Miguel Castillo është 80-vjeçar dhe është studenti i pazakontë i programit "Erasmus". Këtë javë do të nisët në Itali në kuadër të programit "Erasmus", do ta kalojë semestrin e tij të ardhshëm në Verona. Ai është një noter në pension nga Valencia, është babai i tri vajzave dhe gjysh i gjashtë nipërve e mbesave. Profesorët ndalojnë në klasë për ta përshëndetur, ndërsa studentët e urojnë atë.



BARSOLETA E DITËS



Beni: Ma përgatit një pesëshe.
Gjakovari: E do komplet?
Beni: Po, po. Sa të kam borxh?
Gjakovari: 1.50 euro.
Beni: Po i marr edhe dy rrëmojëse.
Gjakovari: O jaran, a kulm të shpisë do me nis a?



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetëm gjatë vikendit në ora 14:00

"FERDINAND"

3D

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 46 min

Rolet: John Cena, Kate McKinnon, Gina Rodriguez, Daveed Diggs, Gabriel Iglesias, Bobby Cannavale, David Tennant, Anthony Anderson, etj.

Regjia: Carlos Saldanha



FOTO E DITES



Atletët garojnë në pjesën 10 kilometra të skajimit në Olimpiadën Dimërore 2018 në Pyeongchang. /AP/

E rrallë

Vidhet statuja dy mijë vjeçare

Autoritetet kineze kanë kërkuar një dënim të ashpër për personin që ka vjedhur statujën e gishtit të ushtarit të terakotës në një shfaqje në ShBA. Statuja është dy mijë vjeçare dhe vlera e saj arrin në 4.5 milionë dollarë. Javën e kaluar Michael Rohana u akuzua për fshehje të një vepre arti të madhe dhe më pas u lirua me kusht. Ushtria terakote është një nga gjetjet arkeologjike të Kinës.



Në ora 22:00 (PG-13)

"THE COMMUTER"

Krim/Dramë/Mister; 1 orë 44 min

Rolet: Liam Neeson, Vera Farmiga, Patrick Wilson, Jonathan Banks, Sam Neill, etj.

Regjia: Jaume Collet-Serra



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.




DASHI

Ditë ideale për të reflektuar dhe për të medituar. Në përgjithësi jeni tip i zhurmshëm, por sot do të jetë krejt e kundërta.



DEMI

Në ambientet që frekuentoni vazhdimisht do të gjeni njerëz që ndajnë të njëjtat ide si ju. Bashkë mund të bënit një skuadër fituese në çdo gjë.



BINJAKËT

Sot jeni i justifikuar nëse shpenzimet tuaja kanë për qëllim dhurata për personat e dashur. Gjithmonë ju kanë akuzuar se jeni egoist në shpenzime.



GAFORRJA

Fantazia e shfrenuar sot do t'ju ndihmojë të harroni për pak momente problemet që jua kanë mbushur ditën. E keni gjetur si rrugë shpëtimi këtë gjë.



LUANI

Sot edhe pse nuk keni qejf të punoni shumë, alternativa interesante do të zgjojnë tek ju ambicien e dikurshme. Do t'i tregoni vetes që ia dilni me pak punë.



VI RGJËR ES HA

Edhe pse në familje ka debate, ju do të dini se si ta riktheni harmoninë e dikurshme. Çdo gjë do të qetësohet gjatë pjesës së dytë të ditës.



PESHORJA

Sonte nuk keni pse mërzhiteni, sepse keni marrë disa ftesa shumë interesante. Ju mjafton vetëm të zgjidhni se ku do të shkoni.



AKREPI

Argëtohuni sot duke hequr mendjen nga gjithçka që ju ka shqetësuar kohët e fundit. Miqtë do të dinë se si t'ju bëjnë t'i harroni problemet.



SHIGJETARI

Disa keqkuptime të vogla do ta ndryshojnë komplet thelbin e bisedës sot. Nuk do të jeni në gjendje të sqaroni atë çka donit të thoni.



BRICJAPI

Këshillat e mira merren gjithmonë në konsideratë. Këtë do të bëni edhe ju sot, sepse e dini mjaft mirë që personat po ua duan të mirën.



UJORI

Doni të niseni sa më parë në udhëtimin që keni planifikuar dhe dita e sotme ju favorizon për këtë gjë. Shijoni momentet larg punës suaj.



PESHQIT

Tensione në vendin tuaj të punës që nuk ju lënë rehat. Por, nga ana sentimentale gjithçka shkon mirë dhe partneri është mbështetësi juaj kryesor.

EURO GLASS
 eg
 SAINT-GOBAIN
 SEKURIT
 PILKINGTON
 Enveri
 Adr: Fushë Kosovë
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
 E-mail: euro.glass@live.com

SPORT

QENDRA SPORTIVE
 "BUJQËSIA"
 TEL: 045/82 82 82

| | | | | | | |
|-------------------|--------------------------|----|---------------------|---|-----------------------|---|
| PROGNOZA SPORTIVE | BAYERN MUNICH - BESIKTAS | 4+ | CHELSEA - BARCELONA | 1 | ASTON VILLA - PRESTON | 1 |
|-------------------|--------------------------|----|---------------------|---|-----------------------|---|

Gërbeshi: Jemi në rrugën e duhur për titull

Drita e Gjilanit e vazhdon garën për titull me hapa të sigurt, pasi e mposhti njëri prej kundërshtarëve kryesor, Feronikelin. Mbrojtësi Fidan Gërbeshi qëndron me këmbë në tokë pas kësaj fitore mjaft të rëndësishme. "Ndeshjen me Feronikelin e vlerësoj si krejt ndeshjet e tjera, por edhe fitorja është e vlefshme sikurse fitoret ndaj skuadrave të tjera. Ne jemi të kënaqur që arritëm tri pikë të plota dhe duhet të vazhdojmë me formë të njëjtë edhe në ndeshjet e tjera", ka thënë Gërbeshi



më gëzojnë shumë. Mirëpo për mua gjithmonë në rend të parë mbesin sukseset e skuadrës", ka shtuar ai. Në derbin e xhiros së parë fitore ka shënuar Prishtina ndaj Llapit me rezultat 2-0, kurse skuadra e Tahir Batatinës e ka humbur pozitën e parë. Kjo nuk i bën përshtypje mbrojtësit shtatlartë, por tregon se lufta për titullin e kampiones në elitë është shumë e hapur. "Neve nuk na intereson shumë se çfarë bëjnë klubet e tjera, sepse jemi të fokusuar vetëm në ndeshjet tona dhe në rezultatet që arrimë. Fakt është se në këtë kampionat nuk ka favoritë për titull dhe besoj se fituesi i kampionatit do të vendoset vetëm në javët e fundit", ka deklaruar ai. Skuadra e Dritës aktualisht renditet në pozitën e tretë me 33 pikë, dy pikë më pak se skuadra e Prishtinës që është lidere e Superligës.

Gjilani e mposhti në shtesë Flamurtarin

Skuadra e Gjilanit ka shënuar fitore si mysafire në ndeshjen përmbyllëse të javës së 19-të në Vala Superligë kundër Flamurtarit (0-1), e cila është zhvilluar të hënën në kryeqytet. Deri te fitorja skuadra e Gjilanit arriti me golin e shënuar në sekondat e fundit të ndeshjes. Në fakt, ishte minuta e 93-të kur Betim Haxhimusa shënoi me kokë pas harkimit të Armend Thaqit nga këndorja. Të dyja skuadrat bënë një paraqitje të mirë në një fushë të vështirë për lojë, e ku nuk munguan as rastet në të dyja anët, por goli erdhi vetëm pak sekonda para përfundimit të ndeshjes. Pas kësaj fitoreje Gjilani ngjitet në pozitën e gjashtë në renditje me 29 pikë, derisa Flamurtari mbetet në pozitën e parafundit, me 11 pikë.

EPOKA E RE **Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 19 SHKURT - KF Drita e ka nisur në mënyrën më të mirë sezonin pranveror në Vala Superligën e Kosovës, pasi e ka mposhtur në derbi skuadrën e Feronikelit. Vendimtar për tri pikët e reja ishte Fidan Gërbeshi, i cili ka realizuar golin e vetëm ndaj ish-skuadrës së tij. Një ditë pas kësaj fitore, mbrojtësi i skuadrës nga Gjilani ka thënë për gazetë se edhe kjo

fitore është e njëjtë me fitoret e tjera. "Ndeshjen me Feronikelin e vlerësoj si krejt ndeshjet e tjera, por edhe fitorja është e vlefshme sikurse fitoret ndaj skuadrave të tjera. Ne jemi të kënaqur që arritëm tri pikë të plota dhe duhet të vazhdojmë me formë të njëjtë edhe në ndeshjet e tjera, pasi kjo është rruga e duhur drejt titullit kampion", ka thënë Gërbeshi. Deri tash Fidan Gërbeshi së bashku me Visar Berishën janë

ndër mbrojtësit që kanë shënuar më së shumti gola. Lidhur me këtë fenomen, Gërbeshi ka thënë se për të rëndësi kanë vetëm sukseset e skuadrës. "Katër gola i kam shënuar dhe normalisht se këto

Kosova sot grumbullohet në Poloni

PRISHTINË, 19 SHKURT - Përfaqësuesja e Kosovës në basketboll sot (e hënë) do të grumbullohet në Poloni, më saktësisht në qytetin Torun, ku do të qëndrojë deri më 22 shkurt, më pas do të zhvendoset për në Wloclawek, aty ku edhe do të zhvillohet përballja me Përfaqësuesen e Polonisë. Kosova do të ballafaqohet me Poloninë më 23 shkurt duke filluar nga ora 19:00 në Wloclawek, kurse menjëherë pas duelit me polakët do të udhëtojnë për në Lituani, ku më 26 shkurt në Klaipeda do të jetë mysafire e Përfaqësueses së Lituanisë, takim ky që do të luhet me fillim nga ora 19:30. Të dyja këto ndeshje i tako-



jnë Dritares së Dytë të Grupit C të kualifikimeve evropiane të Kupës së Botës "Kina 2019", ku Kosova është në grup me Lituani, Hungarinë dhe Poloninë. Duhet

theksuar se në dy ndeshjet e Dritares së Parë të kualifikimeve evropiane për Kupën e Botës "Kina 2019", Kosova ka pësuar disfatë, së pari në shtëpi në për-

ballje me Lituani, më pas si mysafire në ballafaqim me Hungarinë. Në ndeshjen e Dritares së Parë, Përfaqësueses së Kosovës i ka munguar Erjon Kastrati, i cili u pat lënduar një

ditë para duelit me Lituani, gjatë një ndeshjeje me skuadrën e tij slovene, Petrol Olimpija. Kastrati tani është i gatshëm t'i bashkohet Kosovës, ngjashëm si amerikani Shawn Jones.

LISTA E BASKETBOLLISTËVE

- | | |
|-------------------|------------------------------|
| 1. Dardan Berisha | (Basketball Nymburk/Çeki) |
| 2. Erjon Kastrati | (Petrol Olimpija/Sloveni) |
| 3. Scott Bamforth | (Dinamo Sassari/Itali) |
| 4. Jaren Sina | (Ada Blois Basket 41/Francë) |
| 5. Samir Zekiçi | (Trepça) |
| 6. Lis Shoshi | (Pieno Zvaigzdes/Lituani) |
| 7. Gëzim Morina | (Sixt Primorska/Sloveni) |
| 8. Fisnik Rugova | (Sigal Prishtina) |
| 9. Shawn Jones | (Dinamo Sassari/Itali) |
| 10. Leonard Mekaj | (Golden Eagle Ylli) |
| 11. Alban Veseli | (Sigal Prishtina) |
| 12. Granit Rugova | (Sigal Prishtina) |
| 13. Arti Hajdari | (Rahoveci) |

Erisi: Synimi im, ta vazhdoj karrierën futbollistike jashtë Kosovës

Prishtinë, 19 shkurt - 19-vjeçari Eris Bllaca nga Prishtina ka filluar të merret me futboll që në moshën dhjetëvjeçare. Ai sot është pjesë e Klubit KF Kosova (P) dhe mban fanellën me numrin 17, me trajner Naim Pefqeli dhe luan në pozitën e sulmuesit, por edhe të mbrojtësit të majtë. Erisi në një bisedë për gazetën "Epoka e re" ka folur për futbollin në Kosovë, kushtet e klubit dhe synimet e tij në të ardhmen. "Me futboll kam fillu-

ar të merrem që në moshën dhjetëvjeçare, përkatësisht që nëntë vjet. Aktualisht luaj në ligën e parë në Klubin KF Kosova (P) dhe luaj në të gjitha pozitat në sulm dhe mbrojtës i majtë", ka thënë futbollisti Eris Bllaca. Duke folur për kushtet në klub, ai thotë se kushtet nuk janë aq të mira. "Kushtet në klub nuk janë të mira krahasuar me klubet në Evropë, megjithatë kemi vullnet për të luajtur, pavarësisht prej kushteve. Normalisht se kushtet



e mira sjellin edhe cilësi të secili klub i futbollit. Trajneri ynë Naim Pefqeli na jep motiv që ne të sjellim rezultate si klub, pra ai

luan një rol të madh në ecjen e klubit, po ashtu edhe ne si futbollistë të KF Kosova (P) po mundohemi ta japim maksimumin për klubin", është shprehur ai. Erisi thotë se duhet një përkrahje më e madhe e institucioneve për futbollin e Kosovës. "Mendoj se institucionet e Kosovës e përkrahin shumë pak futbollin në krahasim me sportet e tjera. Pra, futbollin në Kosovë është më i neglizhuar nga sportet e tjera.

Kështu mendoj unë", shprehet Erisi. Ai ka bërë me dije se do ta vazhdojë karrierën futbollistike, por synim e ka të luajë për ndonjë klub jashtë Kosovës. "Synimi im si futbollist është gjithmonë t'i arrij majat e këtij sporti. Pra, ta vazhdoj karrierën time si futbollist jashtë Kosovës dhe t'i kënaqi të tjerët me lojën time", ka deklaruar futbollisti Bllaca. Ai ka treguar se klubi më i preferuar i tij është Manchester Unitedi, kurse lojtari Cristiano Ronaldo.

Maliqi: Më falni!

DRENAS, 19 SHKURT - Futbollisti i Feronikelit, Behar Maliqi, është ndëshkuar më karton të kuq në ndeshjen ndaj Dritës. Kapitani i skuadrës nga Drenasi ka kërkuar falje për gjestin e bërë, duke e pranuar se është fajtori kryesor për humbjen e

skuadrës së tij. "Dua t'i kërkoj falje kryesisë së klubit, shtabit teknik, tifozëve të Feronikelit - 'Tigrave të zi', të gjithë sportdashësve të futbollit në Kosovë, sidomos bashkëlojtarëve të mi të cilët i lashë me 10 lojtarë, dhe isha fajtori kryesor për humb-

jen e ndeshjes", ka thënë Maliqi, duke shtuar: "Në raportazhet e ndeshjes shihet reagi mi im jospportiv, mirëpo nuk shihen disa sekonda të mëparshëm të ndeshjes ku para goditje dhe provokime nga ana e kundërshtarit. Gjithsesi pra-

noj se nuk ka justifikim të sillem në atë mënyrë dhe nuk duhet të më ndodhë mua si një lojtar me përvojë. Këto sjellje nuk janë në karakterin tim dhe në kulturën time. Prandaj dua ta shpreh keqardhjen time për reagimin në këtë ndeshje".



Rikthehet derbi i Ligës së Kampionëve: Chelsea - Barcelona

LONDËR, 19 SHKURT (ER) - Skuadra e Chelsea në "Stamford Bridge" e pret sonte (e martë) kryesuesin e La Ligës, Barcelonën, me shpresën që ta ndalin Lionel Messin me shokë. Chelsea ka humbur hapin që ta mbrojë titullin në Premierë Ligë dhe tash të gjitha shpresat i ka në FA Cup dhe Ligën e Kampionëve, por sonte skuadra angleze e ka testin më të vështirë ndoshta në këtë edicion, për faktin se Barcelona ka treguar formë të mirë dhe ka regjistruar vetëm një humbje nga Espanyoli në "Copa del Rey".

Në anën tjetër, Chelsea pas disa humbjeve është rikthyer dhe po arrin rezultate të mira, gjë të cilën synon ta bëjë edhe ndaj Barcelonës. Davi Luizit dhe Tiemoué Bakayoko nuk pritet të jenë të gatshëm për këtë ndeshje, kurse rikthehen Marcos Alonso dhe Ross Barkley. Në dispozicion të trajnerit Conte do të jetë edhe Alvaro Morata, i cili ka qenë pjesë e futbollit spanjoll dhe e njëjshëm skuadrën e Barcelonës. Një opsion tjetër për sulmin anglez është edhe



FORMACIONET E MUNDSHME

Chelsea (3-4-3): Courtois; Rudiger, Christensen, Azpilicueta; Moses, Fabregas, Kante, Alonso; Pedro, Morata, Hazard.
Barcelona (4-4-2): Ter Stegen; Sergi Roberto, Pique, Umtiti, Alba; Paulinho, Rakitiq, Busquets, Iniesta; Suarez, Messi.

francezi Olivier Giroud, i cili gjatë janarit iu bashku Chelsea. Në anën tjetër, Nelson Semedo është pezulluar për ndeshjen në "Stamford Bridge", kurse Philippe Coutinho nuk ka të drejtën të luajë në Ligën e Kampionëve, sepse një gjë të tillë e ka bërë më herët për

Liverpoolin. Ousmane Dembele mund të fillojë përpara Paulinhos ose Ivan Rakitiqit në mesfushë nga minuta e parë. Në orën 20:45 zhvillohet edhe ndeshja tjetër e Ligës së Kampionëve, ku Bayern Muncheni e pret skuadrën turke, Beshiktash.

James mposhti Curryn në 'All Star Game'

LOS ANGELES, 19 SHKURT - LeBron Jamesi merr një lloj revanshi ndaj Stephen Curryt për titullin kampion të NBA-s të humbur sezonin e kaluar. Në "Staples Center" të Los Angelesit, skuadra e yllit të Clevelandit fitoi sfidën spektakolare të "All Star Game" kundrejt asaj të Curryt me rezultatin 148-145. Ishte një sfidë që e përcakttoi vetëm në sekondat e fundit fituesen e saj dhe ajo rezultoi të ishte skuadra LeBron. Minutat e para të ndeshjes ishin të qeta dhe me një ritëm të ulët të lojës, pasi skuadrat tentuan të mbroheshin, ndërkohë që pati edhe sulme të humbara prej tyre. Por me kalimin e minutave të dyja ekipet gjetën ritmin në lojën e tyre, mbrojtja ra në plan të dytë, siç ndodh gjithnjë në "All Star Game" dhe sfida filloi të bëhej gjithnjë e më shumë spektakolare. Në parket u panë aksione fantastike, ndërkohë që u shënuan edhe një sërë guajtjesh të sakta për tre



pikë. Rivaliteti ishte i madh me ekipet që luftonin për çdo pikë, por pjesa e parë u mbyll me avantazhin e skuadrës së Curryt 78-76. Edhe pas pushimit të sfidës rivaliteti në parket ishte i madh, edhe pse në mesin e periodes së 4, skuadra e Curryt u shkëput me 11 pikë kundrejt asaj të James, por kjo e fundit reagoi dhe mori avantazhin kur kishin mbetur 34 sekonda nga fundi i ndeshjes

pikërisht falë yllit të Clevelandit. Dy pikët e tjera nga Westbrook u dhanë avantazhin prej tre pikësh skuadrës LeBron që më pas bëri një mbrojtje fantastike ndaj Curryt në tentativën e këtij të fundit në guajtjen për 3 pikë duke fituar të gjithë ndeshjen. Në fund të sfidës LeBron Jamesi u shpall lojtari më i mirë i kësaj sfide me 29 pikë të shënuara, 10 topa në tabelë dhe 8 asistime.

SHKURT

Hazardi e përsërit: Jam i lumtur te Chelsea

Mesfushori Eden Hazard e ka përsëritur edhe një herë se është i lumtur te skuadra e Chelsea në Premierë Ligë dhe se nuk dëshiron të largohet. Mesfushori belg në vazhdimësi është lidhur me një transferim në Real Madrid ose Paris Saint-Germain. "Dëgjoj shpesh të flitet se do të shkoj te Reali apo te PSG-ja. Ato janë dy klube shumë të mira, por unë luaj te Chelsea dhe jam shumë i lumtur. Tifozët më respektojnë dhe mbështesin, skuadra më vlerëson dhe familja ime ndihet mirë me jetesën në Londër, ndaj për momentin nuk kam ndërmend të lëviz", ka thënë Hazardi.

Skiatori francez përjashtohet nga Fshati Olimpik

Skiatori francez Mathieu Faivre është larguar nga Fshati Olimpik në "Pyeongchang 2018" dhe është dërguar në shtëpi, pasi theu disiplinën. Lajmin e konfirmoi shefi i delegacionit olimpik francez, David Chastan, i cili ka deklaruar: "Është një vendim i marrë nga ne, pasi Mathieu theu disiplinën në skuadër". Faivre u shpreh i pakënaqur për garën e tij në disiplinën e zbritjes së lirë pak ditë më parë. I pyetur për paraqitjen e gjithë ekipit francez, ai ka thënë: "Nuk më intereson rezultati i përgjithshëm i skuadrës, pasi jam këtu për veten time, për ta bërë garën time". Kjo deklaratë nuk i ka pëlqyer shefit të delegacionit olimpik francez, që ka marrë masën e përjashtimit nga Fshati Olimpik të skiatorit.

Pasi është larguar nga Fshati Olimpik, skiatori francez ka postuar një mesazh në faqen e vet zyrtare "Instagram", ku kërkonte falje për sjelljen. "Ky është një sport individual që praktikohet në ekip, por kur je në startin e garës rëndësi ka vetëm paraqitja në pistë. Ndaj, kur më pyetën pas garës mbizotëronte zhgënjimi për garën time. Nuk doja të fyeja askënd dhe jam krenar që përfaqësoj vendin tim", ka shkruar Faivre.

Reali, gati 200 milionë për De Bruyne

"Don Balon" raporton se numri një i Real Madridit, Florentino Perez, është duke bërë gati 200 milionë euro për transferimin e Kevin De Bruyne. Mesfushori i Manchester Cityt është çelësi kryesor i suksesit të jashtëzakonshëm të klubit anglez që po lufton për katër trofe këtë edicion dhe është afër sigurimit të dy prej tyre: Kupën e Anglisë dhe Premierë Ligën. Në anën tjetër, trajneri Zinedine Zidane e pëlqen shumë belgun dhe do të tentojë gjatë verës ta bindë lojtarin për t'u transferuar në "Santiago Bernabeu", lëvizje vështirë e realizueshme, të paktën derisa Pep Guardiola të jetë në stolin e Cityt.

Bonucci: Gattuso na ndryshoi, kemi rrugë të madhe para

Pas fitores ndaj Sampdorias me rezultat 1-0, Leonardo Bonucci e falënderoi Gennaro Gattuson se ka arritur ta transformojë Milanin. Kuqezinjët janë të pamposhtur në 10 ndeshje, duke fituar kështu shtatë dhe kualifikuar për gjysmëfinale të Kupës së Italisë, po ashtu kanë fituar ndeshjen e parë ndaj Ludogorec-it me rezultat 3-0 në Ligën e Evropës. "Që kur ka ardhur Gattuso ne kemi ndryshuar krejtësisht. Një skuadër është formuar, jemi në formë më të mirë dhe është e gjitha meritë e tij. Kemi bërë një hap të madh para dhe duhet të vazhdojmë kështu", ka thënë Bonucci. "Gattuso na ka dhënë mentalitet, një nivel më të mirë fitesi dhe çdo gjë që tjetër që na ka munguar. Ne nuk ishim skuadër para se të vinte ai, kemi vuajtur edhe në aspektin psikologjik. Kemi punuar që të funksionojmë si një njësi", ka deklaruar Bonucci.

Vincenzo Montella u shkarkua në nëntor dhe Gattuso erdhi nga Primavera (skuadra e të rinjve) dhe kjo i ndihmoi shumë Bonucci edhe në aspektin individual. "Mora një pjesë të përgjegjësisë në supet e mia dhe gjeta prapë vetën. Gattuso më ndihmoi në atë aspekt. Në fillim e kisha gabim dhe isha i fokusuar në shumë gjëra rreth meje dhe mendoja se unë duhet ta shpëtoja skuadrën. Por, kuptova se është diçka ekipore dhe duhet të punonim të bashkuar, kemi rrugë të madhe para", ka deklaruar Bonucci.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assembly

SHPLLJE E REKRUTIMIT

01Nr. 111/01-41367/17

Komuna e Kaçanikut, në mbështetje të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregullores Nr.02/2010 për procedurat e rekrutimit në shërbimin civil, më datë 20.02.2018 shpallë konkursin për plotësimin e vendit të lirë të punës:

I. DREJTORI QENDRËS PËR PUNË SOCIALE

Drejtoria: Drejtoria për shëndetësi dhe mirëqenie sociale

Njësia/sektori – Qendra për punë sociale

Kategoria funksionale dhe grada e vendit të punës: niveli drejtues, grada 6, koeficienti aktual- 9.5

Numri i referencës së vendit të punës: JP00032247

Detvat dhe përgjegjësitë

- Udhëheqje punën e përgjithshme të sektorit dhe ndihmon drejtorin në caktimin e objektivave dhe zhvillimin e planit të punës për përbushjen e këtyre objektivave si dhe harton planin e punës për sektorin; 15%
- Menaxhon stafin e sektorit, dhe organizon punën përmes ndarjes së detyrave tek të varurit, si dhe ofron udhëzime dhe monitoron punën e stafit; 15%
- Në bashkëpunim me drejtorin, bën vlerësimin e proceseve dhe procedurave të brendshme dhe rekomandon ndryshime dhe përmirësime me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe cilësisë së punës; 10%
- Shqyrton ankesat e palëve të pakënaqur lidhur me refuzimin e të drejtës për ndihmë sociale nga nëpunësi i ndihmës sociale; 15%
- Përcjellë nevojat sociale në mënyrë që të caktohen prioritetet e punës dhe që të sigurohet mirëqenia sociale duke përfshirë të gjithë qytetarët e në veçanti personat me nevoja të veçanta; 15%
- Nënshkruan të gjitha aktvendimet lidhur me njohjen apo refuzimin e ndonjë të drejte në ndihmë sociale dhe shërbime sociale dhe kujdeset që të mbrohen ato të drejta të garantuara; 15%
- Është i autorizuar të paraqesë kërkesë para gjykatës për të shqyrtuar një urdhër kujdestarie për fëmijët e abuzuar apo të lënë pas dore. 10%
- Bën vlerësimin e rregullt të stafit nën mbikëqyrje të tij dhe përkrahë zhvillimin e tyre përmes trajnimit për kryerjen e detyrave në përputhje me standardet e kërkuara; 5%

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim:

- Në shërbimin civil kanë të drejtë të punësohen shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore, të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen detyrave ekzekutive, drejtuese ose zbatimit e funksioneve administrative dhe të cilat kanë aftësi fizike, që kërkohen për pozitën përkatëse.

Procedura e konkurimit: është e hapur për të gjithë kandidatët e jashtëm si dhe nëpunësit civil ekzistues.

Shkollimi i kërkuar, Aftësitë, përvoja dhetribute tjera që kërkohen:

- Diplomë universitare (minimum me sistem katër vjeçar apo 240 pikë-ECTS) në fushat që ndërlidhen me detyrat e punës.(juridik, sociologji psikologji etj),
- 5 vite përvojë pune profesionale;
- Aftësi komunikuese, negociuese dhe bindëse në menaxhim;
- Shkathtësi në caktim të objektivave , planifikim të punës dhe analizë ;
- Shkathtësi në udhëheqje dhe organizim të ekipit, aftësi për të menaxhuar një ekip ose grup punues;
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Access).

Aktet ligjore dhe nënljgore që rregullojnë rekrutimin: Përzgjedhja bëhet duke u bazuar në Ligjin Nr.03/L-149 për shërbimin civil të Republikës së Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2010 për Procedurat e rekrutimit në Shërbimin Civil.

Kohëzgjatja e emërimit : pa afat të caktuar

Data e mbylljes së konkursit; Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga data e shpalljes në mjetet e informimit publik, prej 20.02.2018 deri më 06.03.2018.

Paraqitja e kërkesave: Formularët e aplikimit merren dhe dorëzohen në Qendrën për shërbim me qytetar - Zyra e pranimit, katë përdrhesë dhe në web-faqen komunale .

Aplikacionit duhet t'i bashkangjiten këto dokumente: Diplomën universitare apo Kopjen e vërtetuar të Diplomës, kopjen e letërnjoftimit, certifikatën-ekstraktin e lindjes, vërtetimin e përvojës së punës, certifikata mbi trajnimet e kryera, dëshminë se nuk është në hetime.

“Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë”. “Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës”

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara mund të refuzohen. Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listen e ngushtë do të kontaktohen. Për çdo informacion kandidatët mund të kontaktojnë zyrën e personelit.

Kryetari i Komunës
Besim Ilazi



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assembly

OGLAS REGRUTOVANJA

01Nr. 111/01-41367/17

Opština Kaçanik, u oslanjanju Zakona Br.03/L-149 Civilne Službe Republike Kosova, Pravilnika Br.02/2010 o procedurama regrutovanja u civilnoj službi, dana 20.02.2018, objavljuje konkurs za dopunu slobodnog radnog mesta: **1.Direktor Centra za Socijalni Rad**

Uprava: Uprava za Zdravstvo i socijalnu zastitu

Odeljenje – CSR

Funkcionalna Kategorija i grada radnog mesta: nivo upravljanja, stepen 6, **aktuelni koeficijent- 9.5**

Broj referencë radnog mesta: JP00032247

Zadaci i Odgovornosti

- Upravlja opštim radon sektora određuje objektivna i plan rada na ispunjavanje istih;
- Upravlja osobljem sektora i organizuje radaraspodelom zadataka kod potčinjenih;
- U saradnju sa direktorom vrši ocenu procesa i unutrašnjih procedura i predlaže izmene za poboljšavanje sa ciljem povećanja efikasnosti i kvaliteta rada;
- Razmatra žalbe nezadovoljnih stranaka vezivanja prava na socijalnu pomoć ;
- Prati socijalne potrebe da bih određio prioritet rada i da se obezbedi socijalno blagostanje obuhvatajući sve gradane posebno lica sa posebnim potrebama;
- Potpisuje rešenja u vezi priznavanja ili odbijanja kojeg prava na socijalnu pomoć usluge i postara se da zaštići ona prava koja su garantovana ;
- Ovlašćen je da podnese zahtev pred sudom. Da bih odredioneredenje starateljstva za zlobotrebijenu decu ili zastapavljeni;
- Vrši redovnu ocenu osobljai podrzava njihov razvoj u skladu sa traženim standardima.

Uslovi ucestvovanja u regrutovanje

U civilnoj službi imaju pravo zapošljavanja,državljeni Republike Kosova punoljetnog uzrasta ,koji imaju punu sposobnost za delovanje,su u posedovanju civilnih i političkih prava,imaju potrebnu obrazovnu spremu i profesionalnu sposobnost za izvršenje izvršnih i upravnih zadataka ili sprovođenje administrativnih funkcija i da imaju fizičke sposobnosti koje se traže za dotičnu poziciju.

Procedura regrutovanja: otvorena za sve vanjske kandidate i postojeće civilne službenike.

Školska sprema,Sposobnosto,iskustvo i ostali atributi koji se traže:

- Univerzitetska Diploma,minimum sa četvorogodišnjim sistemom ili 240 ECTS bodova) smeru iz oblasti koja se nadovezuju sa zadacima rada (pravni, sociologji psihologji itd),
- 5 godina profesionalnog rada;
- Sposobnosti komunikacije, pregovaranje i ubedivanja u menadžiranju
- Veštine u određivanju ciljeva, plana rada i analize
- Veštine u rukovođenju i organizovanju ekipe, sposobnost menadžiranja jedne ekipe ili radne grupe
- Kompjuterske veštine za programsku aplikacije (Word, Excel, PowerPoint, Access)

Zakonski i podzakonski akti koji reguluju regrutovanje: Izbor vrši se oslanjajući se na Zakon Br.03/L-149 civilne službe Republike Kosova i Pravilnika Br.02/2010 o Procedurama regrutovanja u Civilnoj Službi.

Vremetrajnja imenovanja : neograničeno

Datum zaključenja konkursa: Konkurs ostaje otvoren 15 dana od dana objavljivanja u sredstvima javnog informisanja od 20.02.2018 do 06.03.2018.

Podnošenje zahteva: Formulari apliciranja uzimaju se i dostave u skriptarnici -Prijemno odeljenje, prizemlje i u web stranici opštine .

Aplikaciji treba priložiti ove dokumente: Diplomu završenog školovanja ili Overavano Kopije Diplome,kopije licne karte ,ekstrakt rođenja,potvrdu radnog iskustva ,certifikat o završenim trajniranjima ,dokaz da nije pod istragom "Civilna služba Kosova nudi ravnopravne mogućnosti zapošljavanja za sve građane Republike Kosova i očekuje aplikacije svih lica muškog i ženskog roda svih zajednica Kosova""Manjinske zajednice i njihovi pripadnici imaju pravilno i proporcionalno pravo u organima civilne službe javne centralne i lokalne administracije kako je specificirano članom11 paragrafa 3 Zakona Br.03/L-149 Civilne Službe Republike Kosova" Zahtevi dospeli posle istekanja roka neće se primiti. Nekompletirani zahtevi mogu se odbiti. Zbog velikog broja primljenih zahteva samo kandidati izabrani u tesnoj listi će se kontaktirati. Za svaku informaciju kandidati mogu kontaktirati kancelariju personala.



Lumë's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lumë's Details

lumessedetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



KOMPANIA UJËSJELLËSI RAJONAL SH.A.
REGIONAL WATER COMPANY J.S.C.
REGIONALNA KOMPANIJA ZA VODOOSABDEVANJE D.O.O.
PRISHTINA

D P A
Departmenti për punë administrative
Department for administrative works
Prishtinë me 16.02.2018 Nr. 311

Kryeshefi Ekzekutiv i Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit „Prishtina“ sh.a. – Prishtinë, publikon:

KONKURS

Për plotësimin e vendeve të reja të punës në KRU Prishtina sh.a.

1. Tre (3) Operator-Monitorues të Sistemit. (2 në FPU Albanik dhe 1 në FPU Shkabaj)
2. Dy (2) Teknik në mirëmbajtje elektrike-automatike, Departamenti i Mirëmbajtjes Shërbimi i Mirëmbajtjes Elektrike
3. Një (1) Teknik Laborant-dozator, në FPU Shkabaj
4. Dy (2) Ujë Instalues – Montues
5. Tre (3) Punëtor Ndhmës – Në Dep. e Mirëmbajtjes dhe Trajtimin të Ujërave të Zeza
6. Një (1) Teknik në operim (Manipulues i Pompave)
7. Dy (2) Manipulues të Pompave – Bivolak
8. Një (1) Zyrtar i personelit dhe arkivimit të dokumenteve elektronike,
9. Një (1) Ndhmës kontabilist,
10. Një (1) Teknik i TI-së

Kushtet:

Për kryerjen e këtyre punëve, përveç kushteve të përgjithshme, kandidatët duhet të kenë:

Për pikën 1: Kandidati duhet të ketë: - Përgatitjen Universitare Teknike, drejtimi elektroteknikë, automatikë, inxhinieri kompjuterike apo megatronike, - së paku 1 (një) vit përvojë pune, - njohuri në sisteme monitorimi, operimi, sisteme elektrike, sisteme automatike SCADA, - patentin për shofer kategoria “B”.

Për pikën 2: Kandidati duhet të ketë: - Përgatitjen e mesme teknike-drejtimi elektroteknik-automatikë, - së paku 1 (një) vite përvojë pune, - njohuri në sisteme monitorimi, operimi, sisteme elektrike, sisteme automatike PLC SCADA, - patentin për shofer kategoria “B”.

Për pikën 3: Kandidati duhet të ketë: - Pregatitje të mesme teknike, drejtimi teknologji, kimi, biologji,

- së paku 1 (një) vit përvojë pune, - njohuri në teknologjinë e trajtimit të ujit të pijës, - patentin për shofer kategoria “B”.

Vërejtje: Pozita e laborantit-dozator përkon me punë fizike për bartjen e ngarkesave me sulfat alumini, montim të bombolave të klorit si dhe kemikateve të tjera që përdoren për trajtimin e ujit).

Për pikën 4: Kandidati duhet të ketë: - Përgatitjen e mesme teknike, drejtimi hidroinstalues, - së paku 1 (një) vite përvojë pune, - njohuri në sisteme të instalimeve të ujit, - patentin për shofer kategoria “B”. Certifikimet në avansim të teknologjive të reja paraqesin përparësi.

Për pikën 5: Kandidati duhet të ketë: - Pregatitje të mesme teknike, minimum 1 vit përvojë pune, patentin për shofer kategoria “B”. **Për pikën 6:** Kandidati duhet të ketë: - Përgatitje të mesme teknike, Elektro ose makineri, minimum 1 vite përvojë pune, patentin për shofer kategoria “B”.

Për pikën 7: Kandidati duhet të ketë: - Pregatitje të mesme teknike, Elektro ose makineri, minimum 1 vite përvojë pune, patentin për shofer kategoria “B”

Për pikën 8: Kandidati duhet të ketë: - Pregatitje të mesme juridike-ekonomike, minimum 1 vite përvojë pune, shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point). **Për pikën 9:** Kandidati duhet të ketë: - Përgatitjen Universitare Fakulteti ekonomik, së paku 1 vit përvojë pune në financa apo kontabilitet, trajnim të ndryshme në lëminë e kontabilitetit janë me prioritet. **Për pikën 10:** Kandidati duhet të ketë: - Pregatitje të mesme shkollore, kurse të ndryshme në lëminë e IT-se (Cisco, MCP), së paku 1 vite pune në lami të njëjtë. Kushtet e veçanta: Njohuri të mira në instalime të dhe mirëmbajtje të produkteve të Microsoftit, instalime dhe mirëmbajtje të rrjetit local dhe VPN.

Paga mujore: Sipas Rregullores.

Kohëzgjatja e kontratës: Vjetore, me punë provuese gjashtë mujore, me mundësi vazhdimi.

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

- diploma e përgatitjes shkollore;
- kopja e letërnjoftimit;
- çertifikata e lindjes;
- vërtetimi i përvojës së punës;
- Certifikata që nuk është i dënuar dhe nën hetime më e re se 6 muajt;
- Kopja e patentë shoferit.

Procedura për aplikim: Aplikacioni merret në Kompani ose në web-faqën e Kompanisë, të njëjtë bashkëngjiten fotokopjet e dokumenteve personale dhe dokumentacioni tjetër të kërkuar sipas Konkursit dhe dërgohen në adresën KUR „Prishtina“ sh.a. në Prishtinë, Rr. „Hazir Shala“ nr.4., në zyrën nr. 36, më së voni deri me datën **05.03.2018** në ora **16.00**.

Vërejtje: Kërkesat e kandidatëve me dokumente të pakompletuara dhe ato që arrijnë pas afatit nuk do të

merren në shqyrtim. Dokumentacioni i dorëzuar përmes postës pranohet brenda afatit 72 orë pas mbylljes së konkursit.



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Kuvendi Komunal Dragash/Skupština Opštine Dragaš/Dragas Municipality
DREJTORIA KOMUNALE PËR ARSIM



Nr.13/104
Më: 20.02.2018
D r a g a s h

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës nr.04/L-032, nenit 8 të Ligjit mbi Punën në Republikën e Kosovës, nr.03/L-212, Udhëzimit Administrativ nr.17/2009 të datës 28.08.2009, Udhëzimit Administrativ nr.06/2015- normativ mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, Udhëzimit Administrativ nr.05/2015- normativ për mësimdhënësit e arsimit profesional, vendimin e MASHT nr.232/01B, vendimin e MASHT NR.231 të datës, 04 Gusht 2015, kërkesën nga MASHT ref.2-2955 të datës 01 Korrik 2016. Drejtoria Komunale për Arsim në Dragash, shpall:

KONKURS- plotësues

Për plotësimin e vendeve të lira të punës për arsimin fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë të Komunës së Dragashit për vitin shkollor 2017/2018.

SHFMU “Restelica”- Restelicë (Boshnjakisht)

1. Një mësimdhënës për mësim klasor- Restelicë

SHFMU “Svetlost”- Kruševë (Boshnjakisht)

1. Një mësimdhënës për mësim klasor

SHML “Ruzhdi Berisha” Dragash

1. Një profesor të edukatës fizike -14 orë

KUSHTET:

Për të gjitha vendet e punës kërkohet kualifikim përkatës profesional, sipas Udhëzimeve Administrative të MASHT –it (Normativi mbi kuadrin profesional të Arsimit të përgjithshëm).

Formularët për konkurs merren në Drejtorin e Arsimit në Dragash, ku dorëzohen aplikacionet me dokumentet tjera përkatëse.

Diploma duhet të jetë e vërtetuar nga origjinali, në të kundërtën nuk merret si valide, certifikata e lindjes, certifikata që nuk është në hetime, kopja e letërnjoftimit.

Kandidatët të cilët kanë përfunduar studimet jashtë Republikës së Kosovës, duhet të sjellin diplomën e nostrifikuar.

Kandidatët të cilët nuk i plotësojnë kushtet e konkursit nuk do të futen në listën e ngushtë.

Konkursi mbetet i hapur **15 ditë** nga data e publikimit në mjetet e informimit.

Vërejtje: Dokumentacioni i kompletuar për konkurrim nuk iu kthehet kandidatëve.

Datë: 20.02.2018 Drejtori i DKA-së
Dragash

MSc.Vloran Cenaj



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave / Ministarstvo Financija / Ministry of Finance
Thesari i Kosovës/Trezor Kosova/Treasury of Kosovo

Shpallje e Ankandit të Letrave me Vlerë KV002-18

| | |
|--------------------|-------------------------------|
| Afati dhe Lloji | 5 Vite – Obligacion Qeveritar |
| Shuma e Ofruar | €25,000,000 |
| Numri ISIN | KV1211531154 |
| Data e Ankandit | 26.02.2018 |
| Data e Maturimit | 27.02.2023 |
| Mekanizmi i Çmimit | Çmime të Shumfishta |

Shënim: Qeveria e Republikës së Kosovës rezervon të drejtën për ri-bletje të kësaj Letre me Vlerë nëpërmjet operacioneve të përcaktuara në Rregulloren për Tregun Primar dhe Sekondar të Letrave me Vlerë të Qeverisë.

Announcement of Securities Auction KV002-18

| | |
|-------------------|---------------------------|
| Term and Type | 5 Years – Government Bond |
| Offering Amount | €25,000,000 |
| ISIN Number | KV1211531154 |
| Auction Date | 26.02.2018 |
| Maturity Date | 27.02.2023 |
| Pricing Mechanism | Multiple Price |

Note: The Government of the Republic of Kosovo reserves the right to re-purchase this Issue through operations defined in the Regulation for Primary and Secondary Market of Government Securities.

Objava Aukcije Hartija od Vrednosti KV002-18

| | |
|----------------|------------------------------|
| Rok i Tip | 5 Godina – Državne Obveznice |
| Ponuđeni Iznos | €25,000,000 |
| Broj ISIN | KV1211531154 |
| Datum Aukcije | 26.02.2018 |
| Datum Dospeća | 27.02.2023 |
| Mehanizam Cene | Visestruka Cena |


Napomena: Vlada Republike Kosova ima pravo da ponovo otkupi obveznice preko operacija definisanih u Uredbi o Primarnom i Sekundarnom Tržištu Državnih Hartija od Vrednosti.

BQK/CBK Tel.: (038) 222-055 ext. 246

Drejtor i Përgjithshëm i Thesarit

Ahmet Jorgallj





Revistën për kulturë, gjuhë, media, "Akademia", mund ta gjeni në redaksinë e gazetës "Epoka e re", në Sheshin "Edit Durham", 100 metra larg "Grand Hotel"-it. Për informata të tjera mund të thërrisni në këtë numër të telefonit: +377 44 127 434.



NJOFTIM PËR SHITJE PËRMES ANKANDIT TË PARË PUBLIK

Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan-në përbërje të gjyqarit përbarues Avdirrahman Gashi ka nxjerrë Konkluzion E.nr.967/2012,të datës 04.01.2018,për shitjen e pasurisë së paluajtshme të hipotekuar të debitorit NTP"Shpeta",me seli në Prishtinë.

Kjo pasuri e paluajtshme është evidentuar në emër të garantuesit hipotekar Xhemajl Bikliqi nga fshati Janjevë,Komuna Lipjan,pjesa e pronës në 1/1 e pasurisë,e cila evidentohet në fletën e posedimit-çertifikatën mbi të drejtat e pronës:

Fleta poseduese P-71409026-00738-ngastra kadastrale P-1040-0,në sipërfaqe të përgjithshme prej 3495m²,lloji i pronës parcelë,me kulturë bujqësore ,kjo pasuri gjindet në vendin e quajtur "Bara do Puta ",Zona Kadastrale Gushtericë e Ulet,Komuna Lipjan.

Kjo pasuri do të shitet në Ankand Publik, në mbështetje të dispozitës së nenit 234 të Ligjit për Procedurën Përbarimore,me qëllim të sigurimit të mjeteve për të përmbushur obligimet e debitorit NTP "Shpeta"me seli në Prishtinë,ndaj kreditorit Banka Ekonomike sh.a.Prishtinë.

Pasuria e paluajtshme e hipotekuar është e vlerësuar në shumën e përgjithshme prej 122,325.00 Euro.

Në seancën lidhur me ankandin e parë publik, paluajtshmëria nuk mund të shitet për çmimin që është më i vogël se 50%e vlerës së përcaktuar.

Data e mbajtjes së ankandit publik-shitjes së pasurisë:me 22.02.2018.

Koha e shitjes: 10:00

Vendi i shitjes: Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan. Të interesuarit duhet të deponojnë shumën prej 1/10 e vlerës së cekur të pasurisë së paluajtshme, por jo më shumë se 5,000.00 Euro në emër të kaucionit në depozitën e gjyqates,me të drejtë të kthimit të kaucionit-ofertuesve të pasuksesshëm.

www.bekonomike.com

Banka Ekonomike Sh.A
Sheshi Nënë Terezë p.n
10000 Prishtinë, Kosove

info@bekonomike.com
Tel. +381 (0) 38 500 500
Fax. +381 (0) 38 500 507

*Gjithmon me marr malli për verën tëm
Urime dita e pavarësisë!*

RC
cola

*Urime perjetori i 10 Kosovë
Shpresoj që 10 vjetoria e ardhshme
farsjet e mi kanë me qone krenar
me kreni ba se sot*

10 mesazhe Kosovës

*Ndoshta ka shumë punë që me arrit a
kë duhet, por e di që këtu ka gjerez që
shumë dhe kanë besim në ardhmerinë e*

*Sot 10 vjet kjo dite ka qone anderr për n
Qe prej asaj dite ure besoj që puna m
gjithmone kthehet! Urime Kosova jonë!
Zemra pushon vea këtu!*

MADE IN KOSOVA

*Shpresoj ma tmirin për Kosovën
e që vitet e ardhshme tjere ma tsuksesshëm
Gëzuar perjetori i pavarësisë!*

C.nr. 2954/09

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtaren Frosina Sylejmani, në çështjen juridike të paditësit Behram Durmish Hasani nga Prishtina, kundër të paditurve Azem Ejupi, Xhemajl Qazim Galiqi dhe Sali Ejupi, adresa e vend ndodhjes e panjohur, për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm, jashtë seancës gjyqësore me datë 02.11.2015, morri këtë:

AKTVENDIM

Të paditurve Azem Ejupi, Xhemajl Qazim Galiqi dhe Sali Ejupi nga Prishtina i CAKTOHET përfaqësuesi i përkohshëm, Bajram Sherifi avokat nga Prishtina.

Përfaqësuesi i përkohshëm i ka të gjitha autorizimet në këtë çështje, për të ndërmarr të gjitha veprimet juridike për mbrojtjen e interesave të të paditurit deri në momentin kur i padituri të paraqitet personalisht në gjykatë, të caktojë të autorizuarin e tij apo deri në momentin kur organi i kujdestarisë-Qendra për Punë Sociale në Prishtinë, të CAKTOJ KUJDESTARIN.

Shpenzimet për përfaqësuesin e përkohshëm i bartë pala propozuese.

Ky aktvendim do të publikohet në mjetet e informimit publik, tabelën e shpalljeve të kësaj gjykatë, po ashtu i dorëzohet përfaqësuesit të përkohshëm të të paditurit dhe Organit të Kujdestarisë.

Arsyetim

Paditësi pranë kësaj gjykatë ka paraqitur propozimin për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm, kundër të paditurve Azem Ejupi, Xhemajl Qazim Galiqi dhe Sali Ejupi nga Prishtina.

Nga këto arsye gjykata ka vendosur që të paditurve t'i caktoj përfaqësuesin e përkohshëm Bajram Sherifi avokat nga Prishtina, pasi që në rastin konkret të paditurit ndodhen jashtë shtetit ndërsa dërgimi i shkrësave nuk mund të bëhet.


Nga sa u tha më lartë, u vendos në kuptim të nenit 79,3 germa (b), nenit 81,82 dhe 83 të Ligjit për Procedurës Kontestimore.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti i Përgjithshëm

C. nr.2954/09 date 02.11.2015

Këshillë Juridike:
Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.



Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, kompania N.T.P. "Lleshi-F" Gjakovë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për mini thertoren dhe përpunimin e mishit në Gjakovë-J.Qytet, komuna e Gjakovës.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 14. 03. 2018. në ora 14:35 në hapësirat e „ Hotel Jakova" në rrugen Migjeni në Gjakovë, do të organizohet debat publik nga kompania N.T.P. "Lleshi-F" Gjakovë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për mini thertoren dhe përpunimin e mishit në Gjakovë-J.Qytet, komuna e Gjakovës.

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projekti

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Seida Zeçiri shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën shme "Ymer Prizreni " Prizren

► Rifat Haqiq shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën shme "Ymer Prizreni" Prizren

► Nderim Çollaku shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shf "Shtjefen Gjeqovi " Zym

► Lëshoj me qira banesën tri dhomëshe në Bregun e Diellit, mbrapa konvikteve të studentëve, kati VI- lifti funksional, e rinovuar komplet me të gjitha elementet, e mobiluar, ka nxehe qendrore. Banesa lëshohet vetëm për familjar, për banesë duhet të lehet edhe depozitë prej një qeraje. Çmimi 350 euro, tel: 049-400-958

► Agjencia për patundshmëri "SAZANI", kërkon për blerje dhe lëshojmë me qira: banesa, shtëpi, lokale, troje dhe toka. Ndërmjetësorjmë me korrektesë si dhe shesim disa sosh. Numri kontaktues: 044-207-474.

► Shes shtëpinë në rrugën "Haxhi Zeka" afër Shkollës Teknikë në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Tel: 049-909-641.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Ulpiana" afër AAK-së në Prishtinë. Për informata më të hollësishme lajmërohuni në këtë numër të telefonit: 044-162-783

► Kimete Lanaj B.I. kërkon një punëkryes për ndërtimin e serrës me sipërfaqe prej 40 ari, me material të zinguar. Oferta zgjat 5 ditë nga dita e shpalljes në gazetë. Kontakti: 044-528-353.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Kërkoj kamerier me përvojë pune. Gjendemi në Prishtinë te sheshi "Zahir Pajaziti". Nr: kontaktues- 045-999-985.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira kati i parë , në rr. Esat Mekuli, çmimi i volitshëm. Për info. 044/ 477-107 Prishtinë. Çmimi shumë i volitshëm dhe është e mobiluar komplet.

► Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

► Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

► Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044\558-894 Prishtinë.

► Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobilave "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.

► Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo , ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet . Për info: 045/699-221.

► Lëshohet me qira banesa në lagjen Bregu i Diellit te furra Qërimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.

► Lëshohet banesa me qira në Prishtinë në lagjen "Ulpiana", afër AAK-së. Për informata lajmërohuni në tel: 044/162-783

► Lëshoj banesë me qira në Ulpianë, tek Fontana në: E 30-3A, nr.27, kati -IV-. Çmimi sipas marrëveshjes në info: 044-132-368.

► Kërkoj dy bashkëbanuese, mundësisht të cilat janë duke punuar. Banesa gjendet në qendër të qytetit në Prishtinë përball Prokurorisë së shtetit (ish-ndërtesa e OSBE-së, ose ish-ndërtesa e Bankës së Lubjanës), rruga "Hajdar Dushi", afër shtabit kryesor të Policisë së Kosovës. Banesën mund ta shiheni çdo ditë. Numri i telefonit: 049/402-518.

► Shesim banesën dy dhomëshe në Ulpiana D8 h3 Nr 15 kati 3 ndërtim i vjetër, e rinovuar komplet, me nxemje të qytetit , çmimi 77 000€. Informatat tel:049/400-958 dhe 044/627-387



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejite



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administratës Publike / Ministarstvo Javne Administracije / Ministry of Public Administration

MINISTRIA E ADMINISTRATËS PUBLIKE

Uron 10 vjetorin e Pavarësisë



Ministri i Administratës Publike

KOSOVA 10 VJET PAVARËSI
KOSOVO 10 GODINA NEZAVISNOSTI
KOSOVO 10 YEARS OF INDEPENDENCE

Mahir Yagcilar

MEKA
HALAL FOOD



TË GJITHË QYTETARËVE
TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, UA URON
10 - VJETORIN E PAVARËSISË